



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 42

Tiranë – E hënë, 23 shkurt 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 22/2026, datë 3.2.2026	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar..... 3271
Dekret i Presidentit nr. 86, datë 19.2.2026	Për shpallje ligji..... 3273
Udhëzim i ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit nr. 2, datë 20.2.2026	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 5222, datë 26.6.2015, “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, ‘Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes’”, të ndryshuar..... 3273
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Financave dhe i drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës nr. 5, datë 19.2.2026	Për përcaktimin e procedurave të zbatimit të ligjit nr. 85/2025, “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”, për llogaritjen e bazës së tatueshme, paraqitjen dhe administrimin e kërkesës për rivlerësim, pagesën e tatimit të rivlerësimit, rregullat e procedurat për pasqyrimin e rivlerësimit të pasurisë në regjistrat e pasurive të paluajtshme, pagesën e të ardhurave nga tatimi i rivlerësimit në buxhetin e shtetit, si dhe për përcaktimin e tarifës së kryerjes së shërbimeve..... 3276
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 154, datë 16.2.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në Mbretërinë e Bashkuar..... 3287
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 155, datë 16.2.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë..... 3290
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 23, datë 30.1.2026	Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 190, datë 12.8.2025, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Energovia.Albania’ sh.p.k. në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike”..... 3291

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 24, datë 30.1.2026	Mbi vlerësimin e raportit vjetor të Zyrtarit të Përputhshmërisë së shoqërisë “Albgaz” sh.a., për zbatimin e Programit të Përputhshmërisë për vitin 2024.....	3292
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 26, datë 4.2.2026	Mbi licencimin e shoqërisë “Nova Solar System” sh.p.k. në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike	3296
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 27, datë 4.2.2026	Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s lidhur me kërkesën e shoqërisë “Tirana International Development” sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.....	3297
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 29, datë 4.2.2026	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Nova Solar System” sh.p.k., për dhënien e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet marrëveshjes siguruese) të aseteve fikse të saj, si mjet për garantimin e detyrimit ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a.....	3298
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 30, datë 4.2.2026	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë “Breçani - R.O.S.P” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 9, datë 21.1.2022.....	3299
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 31, datë 4.2.2026	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës për veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë “Energy Market Albania” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 138, datë 14.4.2023.....	3301
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 32, datë 4.2.2026	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë “Gerti” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 16.4.2021.....	3302
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 33, datë 4.2.2026	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë “Gerti” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 362, datë 7.12.2023.....	3304
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 34, datë 4.2.2026	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës për veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë “Gerti” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 54, datë 22.2.2021.....	3305
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 35, datë 4.2.2026	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë “HEC Treska” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 80, datë 24.7.2013.....	3307
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 36, datë 4.2.2026	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë “Hydro Power Plant of Korca” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 38, datë 5.4.2012.....	3308
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 37, datë 4.2.2026	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë “Korkis-2009” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 21, datë 4.3.2011.....	3310
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 38, datë 4.2.2026	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë “Mountain’s Green Energy” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 283, datë 18.12.2024.....	3311

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 39, datë 4.2.2026	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë “Peshku-Picar 1” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 24, datë 2.3.2012.....	3313
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 40, datë 4.2.2026	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë “Tirana Energi” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 175, datë 4.11.2020.....	3314



LIGJ
Nr. 22/2026

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 10 221, DATË 4.2.2010,
“PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI”,
I NDRYSHUAR¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar, bëhen disa shtesa e ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 13 ndryshohet si më poshtë:

“13. “Shqetësim” është një formë diskriminimi që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, e cila ka për qëllim ose efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues ose ofendues për këtë person.”.

2. Pika 15 ndryshohet si më poshtë:

“15. “Udhëzim për të diskriminuar” përbën një formë diskriminimi dhe është një udhëzim ose kërkesë për të diskriminuar një ose më shumë persona në bazë të shkaqeve të përmendura në nenin 1 të këtij ligji.”.

3. Në pikën 17 pas togfjalëshit “të nenit 1” shtohet togfjalëshi “dhe nenit 2”.

4. Pas pikës 17 shtohen pikat 18 dhe 19 me këtë përmbajtje:

“18. “Viktimë” është çdo person ose grup personash, të cilët pretendojnë se janë diskriminuar sipas kuptimit të parashikimeve të këtij ligjit ose ligjeve të tjera që rregullojnë barazinë në trajtim,

bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.

19. Termat e përdorur në këtë ligj nënkuptojnë cilindo person që përmbush kriteret e përcaktuara në këtë ligj, pavarësisht gjinisë.”.

Neni 2

Neni 4 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 4
Subjektet

1. Ky ligj zbatohet për sektorin publik dhe privat duke përfshirë edhe institucionet publike, si dhe të gjithë personat, përfshirë, por pa u kushtëzuar në:

a) të gjithë shtetasit shqiptarë, të huaj apo personat pa shtetësi, si dhe personat fizikë e juridikë vendas dhe të huaj që kanë vendbanim, vendqëndrim apo seli në territorin e Republikës së Shqipërisë.

b) shtetasit shqiptarë me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe personat fizikë dhe juridikë shqiptarë me aktivitet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të cilët gëzojnë mbrojtjen që ofron ky ligj në marrëdhënie me autoritetet publike, ose personat fizikë ose juridikë që ushtrojnë veprimtari në sektorin publik ose privat, që ndodhet nën juridiksionin shqiptar.

c) shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi, me banim apo vendqëndrim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe personat fizikë apo juridikë të huaj me aktivitet apo seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të cilët gëzojnë mbrojtjen që ofron ky ligj në marrëdhënie me autoritetet publike ose personat fizikë ose juridikë që ushtrojnë veprimtari në sektorin publik ose privat, që ndodhet nën juridiksionin shqiptar.”.

Neni 3

Në nenin 5 pas pikës 1 shtohen pikat 1/1 dhe 1/2 me këtë përmbajtje:

“1/1. Ndalohet çdo diskriminim për shkak të arsyeve të renditura në nenin 1 të këtij ligji.

¹ Ky ligj është përafëruar me:

- Direktivën e Këshillit 2000/43/KE e 29 qershorit 2000, “Për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë midis

personave, pavarësisht nga origjina racore ose etnike”, OJ L 180, 19.7.2000, pp. 22–26.



1/2. Ndalohet çdo sjellje e përcaktuar në nenin 3, pikat 1 deri 10 dhe 12 deri 17, të këtij ligji.”

Neni 4

Në nenin 7 pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Autoritetet publike dhe subjektet private gjatë ushtrimit të funksioneve dhe veprimtarisë së tyre detyrohen të marrin masa që garantojnë mbrojtjen e çdo individi nga viktimizimi. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi miraton udhëzime për mbrojtjen e individëve nga viktimizimi, duke përfshirë edhe procedurat e ankimit dhe raportimit në të gjitha fushat e parashikuara në këtë ligj, por përgjegjësia për mbrojtjen nga viktimizimi nuk ndikohet nga miratimi i këtyre udhëzimeve.”

Neni 5

Në nenin 17 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1 shkronjat “a” dhe “b” ndryshohen si më poshtë:

“a) krijimin dhe funksionimin e institucioneve arsimore apo profesionale;

b) financimin e institucioneve arsimore apo profesionale;”

2. Në pikën 2 fjala “publik” hiqet.

3. Pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Ndalimi i diskriminimit sipas këtij neni zbatohet në të gjitha nivelet e arsimit, si dhe në institucionet publike dhe ato private që ofrojnë shërbime arsimore apo profesionale për publikun.”

Neni 6

Në nenin 20, pika 2, shkronjat “c” dhe “d” ndryshohen si më poshtë:

“c) trajtim të barabartë për të gjitha skemat e mbrojtjes shoqërore, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, përfshirë asistencën sociale, mbrojtjen e fëmijëve, përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar, paaftësisë për punë, pleqërisë, aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale, papunësisë, si dhe çdo skemë tjetër të mbrojtjes sociale apo avantazh tjetër social i ofruar për publikun;

d) mundësinë për t’u strehuar në një vend ku ofrohet strehim.”

Neni 7

Pas nenit 20 shtohet neni 20/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 20/1

Detyrat e personit fizik dhe drejtuesit të personit juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun

1. Personi fizik ose drejtuesi i personit juridik, që ofron të mira apo shërbime për publikun, është përgjegjës për marrjen e masave me karakter pozitiv, për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën e individëve për të përfituar të mira apo shërbime.

2. Masat që merren nga drejtuesi i personit juridik ndër të tjera përfshijnë:

a) rritjen e ndërgjegjësimit për këtë ligj të personit juridik, ndër të tjera duke e afishuar ligjin në një vend të dukshëm;

b) marrjen e masave kundër modeleve të sjelljes diskriminuese, që përbëjnë ose nxisin diskriminim të personit juridik;

c) marrjen e masave të nevojshme, përfshirë edhe masa disiplinore, për mbrojtjen e përfituesve të të mirave apo shërbimeve nga diskriminimi dhe viktimizimi brenda një muaji nga marrja e dënjës;

ç) trajtimin efektiv të ankesave për diskriminim, duke shqyrtuar çdo ankim brenda 30 ditëve nga paraqitja e tij;

d) marrjen e masave disiplinore ndaj çdo personi që verifikohet të ketë kryer një veprim diskriminues kur një gjë e tillë është e përshtatshme, proporcionale dhe në përputhje me kompetencat e drejtuesit të personit juridik.”

Neni 8

Neni 21 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 21

Komisioneri

1. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (Komisioneri) siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. Komisioneri është person juridik publik.

2. Komisioneri mbështetet nga Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi



(Zyra). Zyra ka personelin, mjetet dhe pajisjet e nevojshme për të mbështetur Komisionerin në përmbushjen e detyrave të ngarkuara me ligj. Punonjësit e Zyrës gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe janë të pavarur në ushtrimin e detyrave të tyre. Përzgjedhja, emërimi, largimi nga detyra dhe konflikti i interesit të personelit i nënshtrohet legjislacionit në fuqi për nëpunësit civil dhe administratën shtetërore.

3. Struktura e organizimit të Zyrës së Komisionerit garanton ushtrimin efektiv, të pavarur dhe të paanshëm të kompetencave të ngarkuara me ligj. Komisioneri miraton strukturën, organikën, si dhe rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të Zyrës së Komisionerit.

4. Kuvendi vendos për pagën e Komisionerit dhe klasifikimin e pagave për punonjësit e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

5. Komisioneri ka buxhetin e vet të pavarur, i cili financohet nga buxheti i shtetit dhe nga donacione të ndryshme. Buxheti i alokuar mundëson burime të mjaftueshme financiare për përmbushjen në mënyrë efektive të detyrave dhe kompetencave të ngarkuara Komisionerit nga ky ligj ose ligje të tjera.

6. Komisioneri është i pavarur në menaxhimin e burimeve të veta financiare, njerëzore dhe teknike. Ai paraqet raport vjetor për menaxhimin financiar dhe performancën organizative në Kuvendin e Shqipërisë. Raporti është publik dhe publikohet çdo vit në faqen zyrtare të Komisionerit.”

Neni 9

Në nenin 33 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pas pikës 11 shtohet pikat 11/1 me këtë përmbajtje:

“11/1. Komisioneri mund të përfshijë në vendimin e tij edhe masa jo të detyrueshme.

Subjektet, sa herë që është e nevojshme, koordinojnë me Komisionerin lidhur me zbatimin e masave detyruese dhe jodetyruese të dhëna prej tij.”

2. Në pikën 18 pas fjalisë së parë shtohet një fjali e dytë me këtë përmbajtje:

“E drejta për ankim në gjykatë zbatohet edhe pasi të ketë mbaruar marrëdhënia në të cilën pretendohet se ka ndodhur diskriminimi.”

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 3.2.2026.

Shpallur me dekretin nr. 86, datë 19.2.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET

Nr. 86, datë 19.2.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 22/2026, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 221, datë 4.2.2010, ‘Për mbrojtjen nga diskriminimi’, i ndryshuar”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

UDHËZIM

Nr. 2, datë 20.2.2026

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN NR. 5222, DATË
26.6.2015, “PËR ZBATIMIN E VENDIMIT
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.
926, DATË 29.12.2014, ‘PËR KRITERET E
VLERËSIMIT TË PRONËS
SHTETËRORE QË PRIVATIZOHET
APO TRANSFORMOHET DHE
PROCEDURËN E SHITJES”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të pikës 14, kreu IV, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes”, të ndryshuar, ministri përgjegjës për ekonominë



UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 5222, datë 26.6.2015, “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, ‘Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes’”, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet si më poshtë vijojnë:

1. Kudo në këtë udhëzim, togfjalëshi “...Ministria e Financave dhe Ekonomisë...” dhe “... Ministri i Financave dhe Ekonomisë...” zëvendësohet me togfjalëshin “...ministra përgjegjëse për ekonominë...” dhe “...ministri përgjegjës për ekonominë”.

2. Kudo në këtë udhëzim, togfjalëshi “...struktura përgjegjëse për privatizim...” zëvendësohet me togfjalëshin “...Drejtoria përgjegjëse për privatizim...”.

3. Kudo në këtë udhëzim, togfjalëshi “...pronë publike...” zëvendësohet me togfjalëshin “...pronë shtetërore...”.

4. Kudo në këtë udhëzim pas fjalës “...eksperti...” shtohet “.../ekspertët...”.

5. Pika 2 e udhëzimit, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Në zbatim të pikës 2, kreu I, të VKM-së nr. 926, datë 29.12. 2014, “Institucionet qendrore dhe organet e njësive të vetëqeverisjes vendore dërgojnë kërkesat e tyre për privatizimin e pronave shtetërore që kanë në administrim ose në pronësi në ministrinë përgjegjëse për ekonominë. Ministri përgjegjës për ekonominë nxjerr urdhrin për fillimin e procedurave të privatizimit, sipas kërkesave të përmendura më sipër. Në rast se ministria përgjegjëse për ekonominë u kërkon institucioneve qendrore apo organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore kërkesën për prononcim privatizimi për pronat e paluajtshme shtetërore që kanë në administrim ose në pronësi, këto institucione janë të detyruara që, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës, të dërgojnë mendimin e tyre për privatizimin e këtyre pasurive. Nëse institucionet qendrore apo organet e njësive të vetëqeverisjes vendore shprehen për mosprivatizimin e pronave shtetërore në administrim apo në pronësi, apo pronave shtetërore të institucioneve që kanë në varësi administrative, atëherë ato duhet ta argumentojnë qartë këtë fakt. Për të përfshirë në procesin e privatizimit pronat, të cilat i kanë kaluar në pronësi pushtetit vendor, duhet

miratimi përkatës i këshillit bashkiak dhe konfirmimi nga institucioni i prefektit për ligjshmërinë e tij.

Miratimi për përfshirjen në procesin e privatizimit të objekteve ndërtimore, të cilët kanë qenë në administrim të një subjekti që nuk ekziston më, bëhet nga ministri përgjegjës për ekonominë.”.

6. Pika 4 e udhëzimit, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Në zbatim të pikave 3, 4 dhe 5, të kreut II, të VKM-së nr. 926, datë 29.12.2014, genplani përgatitet nga eksperti/ekspertët vlerësues i/të licencuar i/të pasurisë së paluajtshme, i cili/të cilët mban/mbajnë përgjegjësi ligjore për hartimin e genplanit dhe për saktësinë e matjeve teknike të kryera. Genplani i përgatitur, i dorëzohet menjëherë nga eksperti, degës përkatëse të shoqërive publike. Nëse, pas hartimit të genplanit nga eksperti/ekspertët vlerësues, rezultojnë sipërfaqe truall të lira (më shumë se sipërfaqja nën objekt dhe ajo funksionale), institucioni administrues, në zbatim të procedurave ligjore përkatëse, ia kalon ato Agjencisë së Trajtimit të Pronave, për përdorimin për fond kompensimi për ish-pronarët ose për kthim fizik. Dega e shoqërive publike dërgon kërkesën për konfirmimin e genplanit, shoqëruar me pesë kopje origjinale të tij, pranë institucionit të PREFEKTIT. Ky i fundit, ose përfaqësuesi i autorizuar prej tij, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së kërkesës, konfirmon genplanin e objektit, duke nënshkruar e vulosur atë në pesë kopje origjinale dhe ia dërgon degës së shoqërive publike të shoqëruar me shkresën përcjellëse.”.

7. Pika 9 e udhëzimit, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Në zbatim të pikës 8, të kreut II, të VKM-së nr. 926, datë 29.12.2014, komisioni i vlerësimit merr nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës nga degët vendore përkatëse, dokumentacionin e pronësisë për pronën shtetërore që do të privatizohet, i cili duhet të përmbajë kartelën e pasurisë, hartën treguese, si dhe certifikatën e pronësisë nëse ka (dokumenti duhet të përmbajë datën dhe vulën). Dega e shoqërive publike pas marrjes së dokumentacionit nga drejtoria vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, i kërkon Agjencisë së Trajtimit të Pronave konfirmimin nëse për truallin përkatës ka pronarë të njohur apo të kthyer me vendim të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si dhe çmimin përkatës të truallit ku shtrihet objekti.”.



8. Paragrafi i tretë, i pikës 11 të udhëzimit, riformulohet si më poshtë vijon:

“Drejtoria përgjegjëse për privatizim në ministrinë përgjegjëse për ekonominë, pasi verifikon nëse dokumentacioni i marrë nga institucionet përkatëse është i plotë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore, ia përcjell atë Komisionit të Shqyrtimit dhe Transparencës, së bashku me vlerësimin përmbajtësor.

Dokumentacioni duhet të shoqërohet edhe me një inventar fizik të plotë.”

9. Pikat 11.1 deri 11.4 të udhëzimit, riformulohen si më poshtë vijon:

“11.1 Në zbatim të pikës 12/1, të kreut II, të VKM-së nr. 926 datë 29.12.2014, Komisioni i Shqyrtimit dhe Transparencës ngrihet me urdhër të ministrit përgjegjës për ekonominë dhe ka në përbërje 5 (pesë) anëtarë, përfaqësues të strukturave përgjegjëse të ministrisë përgjegjëse për ekonominë. Komisioni drejtohet nga zëvendësministri.

11.2 Komisioni i Shqyrtimit dhe Transparencës mbledhet me kërkesë të kryetarit, për shqyrtimin e dokumentacionit për privatizimin e pronës shtetërore, që dërgohet për shitje, sa herë që drejtoria përgjegjëse për privatizimin e pronës shtetërore në ministrinë përgjegjëse për ekonominë, i përcjell dokumentacionin e privatizimit.

Mbledhja e Komisionit zhvillohet vetëm pasi të sigurohet pjesëmarrja e jo më pak se 4 (katër) anëtarëve.

Komisioni gjatë mbledhjeve asistohet nga Sekretariati i Komisionit, i cili përbëhet nga 1 (një) anëtar nga drejtoria përgjegjëse për privatizim, i cili emërohet dhe lirohet me urdhër të ministrit përgjegjës për ekonominë. Me kërkesë të kryetarit të Komisionit, sekretariati ka detyrimin të njoftojë anëtarët e Komisionit për vendin, datën, orën dhe agjendën e mbledhjes.

Komisioni i Shqyrtimit dhe Transparencës shqyrton materialin që i vjen nga drejtoria përgjegjëse për privatizimin dhe del me vendim, brenda 7 (shtatë) ditëve pune nga administrimi i dosjes në Komision.

Vendimet e anëtarëve në Komision merren me shumicë të anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Si rregull gjatë votimit kryetari voton i fundit dhe në rast barazie votash, vota e kryetarit prevalon në vendimarrje.

11.3 Komisioni i Shqyrtimit dhe Transparencës ka për detyrë të shqyrtojë dokumentacionin e

vlerësimit për privatizimin e pronës shtetërore, i cili është përcjellë nga drejtoria përgjegjëse për privatizimin e pronës shtetërore.

Në përfundim të shqyrtimit, Komisioni i Shqyrtimit dhe Transparencës merr vendim për:

- t'i rekomandojë ministrit përgjegjës për ekonominë dërgimin e dokumentacionit të vlerësimit, në strukturën përgjegjëse për shitjen e pronës shtetërore, për të vijuar me procedurat e shitjes;

- kthimin e dokumentacionit të vlerësimit (duke argumentuar arsyet e kthimit) pranë drejtorisë përgjegjëse për privatizimin, me qëllim që kjo e fundit ta kthejë këtë dokumentacion pranë degëve të shoqërive publike për plotësimin e tij.

Bazuar në vendimin e Komisionit të Shqyrtimit dhe Transparencës drejtuar ministrit përgjegjës për ekonominë, dokumentacioni i vlerësimit i përcillet strukturës përgjegjëse për shitjen e pronës shtetërore, në ministrinë përgjegjëse për ekonominë.

Vendimi i Komisionit të Shqyrtimit dhe Transparencës duhet të shoqërohet edhe me një kopje të procesverbalit të mbajtur gjatë mbledhjes së tij.

11.4 Sekretariati mban përgjegjësi për:

a) administrimin e dokumentacionit sipas inventarit fizik të tij, i cili i është vënë në dispozicion nga drejtoria përgjegjëse për privatizim;

b) mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes, si dhe të gjitha akteve apo njoftimeve sipas kërkesave të Komisionit të Shqyrtimit dhe Transparencës;

c) zbardhjen e vendimit të Komisionit të Shqyrtimit dhe Transparencës, të pasqyruar në procesverbalin e mbledhjes dhe të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e pranishëm në mbledhje;

d) përcjelljen e vendimit të Komisionit të Shqyrtimit dhe Transparencës së bashku me dokumentacionin e vlerësimit, tek ministri përgjegjës për ekonominë, të nënshkruar sipas vendimarrjes nga të gjithë anëtarët e pranishëm në mbledhje.”

10. Pikat 11.5 dhe 11.6 të udhëzimit shfuqizohen.

11. Në fund të pikës 26 të udhëzimit, shtohen paragrafët, si më poshtë:

“Blerësi, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e zhvillimit të ankandit, është i detyruar të bëjë pagesën, vetëm me lekë, për pjesën e mbetur, sipas çmimit të arritur në ankand, për objektin dhe truallin.



Në rastet kur nuk respektohet afati 30 (tridhjetë) ditë i pagesës së vlerës së plotë të objektit bashkë me truallin, për arsye objektive të justifikuara, me autorizim të drejtorit të strukturës përgjegjëse për shitjen e pronës publike afati zgjatet, por jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga përfundimi i afatit tridhjetëditor.”.

12. Në fund të pikës 28 të udhëzimit, shtohet paragrafi, si më poshtë:

“Në rast se nga informacioni zyrtar i marrë nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës rezulton se objekti i kontratës së qirasë me tarifë 1 euro/kontrata nuk është në regjistrat kadastralë, sipas akteve ligjore dhe nënligjore përkatëse, nëse plotësohen rrethanat e parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 34, të kreut III, të VKM-së nr.926, datë 29.12.2014, trualli do të shitet nga struktura për shitjen e pronës publike dhe lidhja e kontratës bëhet sipas dispozitave të Kodit Civil, pasi të jetë bërë pagesa e plotë sipas vlerësimit të objekteve, bazuar dhe në vendimin e Komisionit të Shqyrtimit dhe Transparencës.”.

13. Pas pikës 33, të kreut III, të udhëzimit shtohet pika 33.1 me këtë përmbajtje:

“33.1 Në zbatim të pikës 33, të kreut III, të VKM-së nr. 926 datë 29.12.2014, ministri përgjegjës për ekonominë nxjerr urdhrin për përfshirjen në procedurë privatizimi të pronës shtetërore, objekt kontrate, të dhënë me qira me tarifë 1 euro/kontrata, me sipërfaqe mbi 500 (pesëqind) m², përpara përfundimit të kontratës së qirasë.”.

14. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË
DHE INOVACIONIT
Delina Ibrahimaj

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 5, datë 19.2.2026

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË ZBATIMIT TË LIGJIT NR. 85/2025, “PËR RIVLERËSIMIN E PASURISË SË PALUAJTSHME”, PËR LLOGARITJEN E BAZËS SË TATUESHME, PARAQITJEN DHE ADMINISTRIMIN E KËRKESËS PËR RIVLERËSIM, PAGESËN E TATIMIT TË RIVLERËSIMIT, RREGULLAT E PROCEDURAT PËR PASQYRIMIN E RIVLERËSIMIT TË PASURISË NË REGJISTRAT E PASURIVE TË PALUAJTSHME, PAGESËN E TË ARDHURAVE NGA TATIMI I RIVLERËSIMIT NË BUXHETIN E SHTETIT, SI DHE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË KRYERJES SË SHËRBIMEVE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 3, të ligjit nr. 85/2025, “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”, ministri i Financave dhe drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës,

UDHËZOJNË:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME PËR RIVLERËSIMIN E PASURISË SË PALUAJTSHME PËR INDIVIDËT

1. Të gjithë individët, të cilët kanë në pronësi, pasuri të paluajtshme (tokë dhe/ose ndërtesë) të regjistruar ose që fitojnë pronësinë dhe e registrojnë atë deri më 31 dhjetor 2026, kanë të drejtë që brenda afatit të përcaktuar në ligjin nr. 85/2025, “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme” (këtu e më poshtë “ligji”), të bëjnë rivlerësimin e kësaj pasurie me vlerën e tregut. Këtu përfshihen dhe rastet, kur për pasurinë e paluajtshme është bërë edhe më parë rivlerësimi, në zbatim të ligjeve të mëparshme të rivlerësimit.

2. Individit mund të zgjedhë vullnetarisht nëse rivlerësimin e pasurisë do ta bëjë pranë drejtorisë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (DVASHK), apo me një ekspert të licencuar nga institucionet përkatëse për vlerësimin e pasurive të paluajtshme. Për të përfituar nga rivlerësimi, nëpërmjet pasqyrimit të tij në regjistrin e pasurive të paluajtshme, individit duhet të paguajë më parë



tatimin e rivlerësimit (5% e bazës së tatueshme) dhe tarifën e kryerjes së shërbimit, sipas ligjit dhe këtij udhëzimi.

3. Në rast se individ i ka në pronësi më shumë se një pasuri të paluajtshme dhe do të bëjë rivlerësimin e secilës prej tyre, procedura e rivlerësimit është individuale për secilën prej këtyre pasurive.

II. LLOGARITJA E BAZËS SË TATUESHME PËR RIVLERËSIMIN E PASURISË PËR INDIVIDËT

1. Në rast se individ i zgjedh që rivlerësimin e pasurisë ta bëjë ASHK-ja, ai bëhet me çmimet minimale fiskale, që janë në fuqi në momentin e kryerjes së procesit të rivlerësimit dhe në përputhje me përcaktimet e udhëzimit të përbashkët nr. 34, datë 29.12.2023, “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme”. Në këtë rast, baza e tatueshme, llogaritet si diferencë ndërmjet vlerës së dalë nga rivlerësimi (sipas çmimeve minimale fiskale në fuqi) dhe vlerës së zbritshme të përcaktuar në pikën 3 të këtij kreu.

1.1 Çmimi minimal fiskal, bazuar në udhëzimin e përbashkët nr. 34/2023, “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme”, do të konsiderohet çmimi i referencës për pasurinë e paluajtshme ndërtesa dhe sipas hartës së vlerave për pasurinë e paluajtshme tokë.

a) Në rastin e ndërtesave, çmimeve të referencës do t'i zbritet 1% e vlerës për çdo vit të plotë shtesë përdorimi, duke filluar nga data e fitimit të titullit të pronësisë për herë të parë. Zbritja prej 1% do të aplikohet për të gjitha llojet e pasurive të paluajtshme ndërtesa. Kjo zbritje nuk duhet të jetë më e madhe se 30% e çmimit të referencës të përcaktuar në VKM-në në zbatim të neneve 21, pika 2, 22, pika 5, 22/1, 22/3 dhe 22/4 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.

b) Në rastin e tokave çmimi minimal fiskal është çmimi për metër katror sipërfaqeje, të përcaktuar në hartën e vlerave, sipas aktit nënligjor në fuqi në datën e rivlerësimit.

2. Në rast se individ i zgjedh rivlerësimin e pasurisë nga një ekspert i licencuar, baza e tatueshme, llogaritet si diferencë ndërmjet vlerës së pasqyruar në aktin e vlerësimit të pasurisë dhe vlerës së zbritshme. Në çdo rast, vlera e pasqyruar në aktin e vlerësimit të pasurisë nga eksperti i licencuar nuk mund të jetë më e vogël se çmimi minimal fiskal.

3. Vlera e zbritshme, si në rastin e pikës 1 dhe në atë të pikës 2 të këtij kreu, është vlera e pasurisë sipas aktit të fundit të regjistruar pranë organit kompetent për regjistrimin e pasurive të paluajtshme (qoftë kontratë blerje, shkëmbim, trashëgimi, dhuratë, heqje dorë, apo rivlerësim i pasurisë së paluajtshme), për të cilin është llogaritur dhe paguar tatimi.

3.1 Në rastet kur pasuria e paluajtshme rezulton e regjistruar pa vlerë, për të përcaktuar vlerën e zbritshme, si vlerë regjistrimi do të konsiderohet vlera sipas parashikimeve të paragrafit 3.2 të udhëzimit të përbashkët nr. 34/2023.

Konkretisht, në rastet kur nuk mund të përcaktojmë një vlerë të zbritshme, sipas parashikimeve të pikës 3 të këtij kreu, atëherë vlera e zbritshme do të jetë si në vijim:

a) Për ndërtesat e ndërtuara dhe të regjistruara në DVASHK, të cilat nuk kanë vlerë të regjistruar, ose vlera e regjistruar është e shprehur në monedha të tilla, si franga ari, apo napolona floriri, si dhe për ndërtesat e privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, i ndryshuar, për efekt të përcaktimit të tatimit mbi rivlerësimin, si vlerë e zbritshme do të merret kostoja e shfrytëzimit për metër katrorë e përcaktuar nga akti nënligjor në fuqi për Entin Kombëtar të Banesave, në vitin e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme.

Për ndërtesat e përfutuara në rastet e trashëgimisë, dhuratave apo heqjes dorë, për të cilat nuk ka qenë regjistruar vlerë e pronës, si vlerë e zbritshme do të merret kostoja e shfrytëzimit për metër katrorë, e përcaktuar nga akti nënligjor në fuqi për Entin Kombëtar të Banesave në datën e regjistrimit të aktit.

b) Për tokën, në të gjitha rastet, nëse nuk ka një vlerë në regjistrim, si vlerë e zbritshme do të merret vlera e llogaritur, duke përdorur indeksimin e çmimit të tokës sipas hartës së vlerave, me inflacionin mesatar vjetor të llogaritur për vitin në të cilin është fituar pronësia, sipas aneksit nr. 1 bashkëngjitur udhëzimit të përbashkët nr. 34/2023.

III. PARAQITJA DHE ADMINISTRIMI I KËRKESËS PËR RIVLERËSIM NGA INDIVIDËT

1. Individ i ose përfaqësuesi i tij aplikon *online* për shërbimin e rivlerësimit të pasurisë, nëpërmjet portalit qeveritar *e-Albania*, me kërkesën sipas modelit të shtojcës nr.1, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Në mënyrë që të pajiset me dokumentin



zyrtar që pasqyron regjistrimin e shërbimit të rivlerësimit, ai duhet të aplikojë edhe për shërbimin e pajisjes me kopje të kartelës së pasurisë së paluajtshme ose kartelë jopërfundimtare (për pasuritë që ndodhen në zona që nuk i janë nënshtruar regjistrimit fillestar).

Aplikimi për shërbimet i drejtohet drejtorisë/zyrës vendore të ASHK-së, e cila është kompetente për territorin ku gjendet pasuria e paluajtshme.

1.1 Individi në aplikimin *online* për shërbimin për rivlerësimin e pasurisë duhet të plotësojë në rubrikat përkatëse të platformës *e-Albania*, të dhënat identifikuese të pasurisë që kërkohet të rivlerësohet. Nëse individi nuk plotëson rubrikat që identifikojnë pasurinë, ai duhet, detyrimisht, të ngarkojë në platformë kopje të skanuar të dokumentit të pronësisë që disponon për pasurinë.

1.2 Punonjësi i drejtorisë vendore të ASHK-së shqyrton aplikimin, duke verifikuar:

- a) identifikimin e pasurisë, sipas përcaktimeve të pikës 1.1 të këtij kreu; dhe
- b) legjitimitetin e individit aplikues.

Punonjësi verifikon nëse individi që ka paraqitur kërkesën për rivlerësim (ose i përfaqësuar) është pronar, apo një nga bashkëpronarët e pasurisë që kërkohet të rivlerësohet.

Nëse nuk përmbushen kushtet e mësipërme, individi njoftohet nëpërmjet platformës, për të identifikuar pasurinë ose për mosvijimin e aplikimit (në rast moslegjitimiteti).

1.3 Nëse aplikimi i përmbush kushtet e pikës 1.2 të këtij kreu, vijohet me llogaritjen e tatimit të rivlerësimit, sipas rregullave të kreut II të këtij udhëzimi, duke hartuar faturën për arkëtim brenda 2 (dy) ditëve pune, nga momenti i paraqitjes së kërkesës.

1.4 Fatura për arkëtim plotësohet sipas modelit të shtojcës nr. 3 bashkëlidhur, që është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi. Fatura gjenerohet në mënyrë elektronike nga drejtorja vendore e ASHK-së dhe së bashku me tarifën e shërbimit, i dërgohet aplikuesit nëpërmjet portalit qeveritar *e-Albania*.

1.5 Në rastet kur individi kërkon rivlerësimin e pasurisë sipas aktit të ekspertit, individi nëpërmjet platformës *e-Albania*, në dokumentacionin shoqërues gjatë kërkesës për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme, bashkëlidh edhe aktin e vlerësimit të pasurisë, të nënshkruar dhe vulosur në mënyrë elektronike nga eksperti, si dhe fotokopje e njësuar e licencës së tij. Me përcjelljen e këtyre dy

dokumenteve, si më sipër, drejtorja vendore e ASHK-së vijon procedurat për përlllogaritjen e tatimit të rivlerësimit dhe i njofton subjektin vlerën e tatimit të rivlerësimit dhe tarifave të shërbimit.

IV. PAGESA E TATIMIT DHE E TARIFËS SË SHËRBIMIT TË RIVLERËSIMIT NGA INDIVIDËT

1. Pasi individi ose përfaqësuesi ligjor është pajisur me faturën për arkëtim (shtojca nr. 3 bashkëlidhur këtij udhëzimi), ai paguan faturën për arkëtim dhe drejtorja vendore e ASHK-së kryen konfirmimin e shlyerjes së pagesës së tatimit të rivlerësimit dhe të tarifave të shërbimit.

2. Pas verifikimit të shlyerjes së pagesës së tatimit të rivlerësimit dhe të tarifave të shërbimit, aplikimi i individit konsiderohet i plotësuar dhe ASHK-së i lind detyrimi për të pasqyruar rivlerësimin në regjistrin e pasurive të paluajtshme, sipas rregullave të parashikuara në kreun V të këtij udhëzimi.

V. RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR PASQYRIMIN E RIVLERËSIMIT TË PASURISË NË REGJISTRAT E PASURIVE TË PALUAJTSHME

1. Drejtorja vendore e ASHK-së, brenda 5 ditëve nga verifikimi i pagesës së tatimit të rivlerësimit të pasurisë dhe tarifave të shërbimit, duhet të kryejë shënimet përkatëse në regjistrat e pasurive të paluajtshme, për pasqyrimin e rivlerësimit, nëpërmjet punonjësit të ngarkuar me këtë detyrë. Data e rivlerësimit të pasurisë është data e pagimit të tatimit të rivlerësimit.

2. Punonjësi i ASHK-së kryen shënimet përkatëse në regjistrat e pasurive të paluajtshme, bazuar në dokumentacionin tekniko-ligjor, sipas rasteve të parashikuara më poshtë:

2.1 Kur pasuria e paluajtshme, objekt rivlerësimi, figuron e regjistruar në regjistrat kadastralë dhe ndodhet në një zonë që i është nënshtruar procesit të regjistrimit fillestar, pasqyrimi i rivlerësimit të pasurisë kryhet në seksionin “A” të kartelës së pasurisë.

Në këtë seksion do të regjistrohet data e rivlerësimit të pasurisë së paluajtshme, shuma e rivlerësimit dhe arkivohet dokumentacioni në referencën përkatëse.

2.2 Kur pasuria e paluajtshme, objekt rivlerësimi, ndodhet në një zonë që i është nënshtruar regjistrimit fillestar, por kjo pasuri nuk figuron e regjistruar në regjistrin kadastral, subjekti fillimisht duhet të aplikojë nëpërmjet portalit unik qeveritar *e-*



Albania për regjistrimin e kësaj pasurie, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, dhe të VKM-në nr. 389/2020, “Për miratimin e listës dhe tarifave të shërbimeve kadastrale”, të ndryshuar, duke depozituar titullin e pronësisë dhe dokumentacionin provues për regjistrim. Vetëm pas regjistrimit të kësaj pasurie në regjistrin kadastral, subjektit i lind e drejta të aplikojë për rivlerësimin e kësaj pasurie, sipas përcaktimeve dhe brenda afatit të parashikuar në këtë udhëzim.

2.3 Kur pasuria e paluajtshme, objekt rivlerësimi, gjendet në një zonë kadastrale që nuk i është nënshtruar procesit të regjistrimit fillestar, procedohet me pasqyrimin e vlerës së rivlerësimit në regjistrin përkatës hipotekar apo në kartelat jopërfundimtare, duke pasqyruar datën e rivlerësimit të pasurisë së paluajtshme, shumën përkatëse të rivlerësimit dhe referencën arkivore përkatëse.

Në përfundim të procesit të regjistrimit fillestar, shënimet e mësipërme të rivlerësimit pasqyrohen në kartelat e pasurive të paluajtshme, produkt i këtij procesi, në rastet kur titulli i pronësisë konstatohet se është në përputhje me ligjin. Përfundimisht, në rastet kur refuzohet regjistrimi i titullit të pronësisë, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, dhe të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH”, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tyre, vlera e rivlerësimit nuk pasqyrohet në kartelën e pasurisë së paluajtshme dhe shuma përkatëse nuk i kthehet subjektit.

VI. RIVLERËSIMI I PASURIVE TË PALUAJTSHME TË PERSONAVE JURIDIKË

1. Personat juridikë, të cilët kanë të regjistruara në pasqyrat financiare të vitit 2025, në zërin aktive afatgjata materiale, pasuri të paluajtshme me vlerë kontabël më të vogël se vlera e tregut, kanë të drejtë të bëjnë, brenda periudhës së zbatimit të këtij ligji, rivlerësimin e këtyre pasurive të paluajtshme me vlerën e tregut. Rivlerësimi me vlerën e tregut bëhet nga vlerësues të pasurisë, ekspertë të pavarur të licencuar nga institucionet përkatëse për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme.

2. Përfaqësuesi i personit juridik paraqet pranë drejtorisë rajonale tatimore, ku personi juridik është i regjistruar, dokumentet e mëposhtme:

a) deklarin vullnetar për rivlerësimin e pasurisë, sipas shtojcës nr. 2 bashkëlidhur këtij udhëzimi;

b) prokurën për përfaqësuesin ligjor, nëse kjo procedurë kryhet nga një përfaqësues ligjor i caktuar prej tij;

c) kopje të licencës së ekspertit të pavarur të vlerësimit të pasurisë;

d) kopje të faturës së shërbimit të ekspertit të vlerësimit të pasurisë;

e) aktin origjinal të vlerësimit të pasurive të paluajtshme, të nënshkruar dhe të vulosur nga vlerësuesi i pasurisë;

f) pasqyrën financiare (bilancin kontabël) të vitit 2025, ku rezulton e regjistruar në zërin aktive afatgjata materiale, pasuria e paluajtshme që rivlerësohet, përfshirë anekset shpjeguese për aktivin afatgjatë material që rivlerësohet;

g) kopjen e mandatit të pagesës për vlerësimin e pasurisë, në masën 5% të diferencës, ndërmjet vlerës së rivlerësimit dhe vlerës kontabël për pasuritë e paluajtshme të regjistruara në pasqyrat financiare. Pagesa kryhet në njërin nga bankat e nivelit të dytë për llogari të thesarit të Ministrisë së Financave, sipas formatit të përcaktuar në shtojcën nr. 4 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Personi juridik mban një kartelë të pasurisë së paluajtshme, ku evidenton vlerën përkatëse të pasurisë së paluajtshme që nga momenti i njohjes fillestare të aktivit dhe tatimin përkatës, të paguar sipas legjislacionit në fuqi.

2.1 Data e rivlerësimit të pasurive të paluajtshme konsiderohet data e pagesës së kryer, siç përcaktohet në pikën 4, të nenit 2, të ligjit nr. 85/2025, “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”.

2.2 Diferenca midis vlerës që rezulton nga rivlerësimi, sipas aktit përkatës të ekspertit dhe vlerës kontabël të regjistruar në pasqyrat financiare, regjistrohet përkatësisht në zërin përkatës të pasqyrave financiare, në përputhje me ligjin nr. 25, datë 10.5.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, si dhe në përputhje me ligjin nr. 29, datë 30.03.2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar. Kjo vlerë nuk është objekt amortizimi për qëllime tatimore.

2.3 Pasqyrave financiare për rivlerësimet që kryhen brenda periudhës gjatë së cilës i shtrihet efektet ligji, sipas nenit 4 të tij, u bashkëlidhen pasqyrat analitike të vlerës kontabël të pasurive të paluajtshme të rivlerësuar.



VII. PAGESA E TË ARDHURAVE NGA TATIMI I RIVLERËSIMIT NË BUXHETIN E SHTETIT

1. Pagesa e tatimit nga rivlerësimi i pasurive të paluajtshme kryhet sipas modeleve të formularit të faturës për arkëtim, përkatësisht, për individët (shtojca nr. 3) ose për personat juridikë (shtojca nr. 4), që i bashkëlidhen këtij udhëzimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Individëve iu vihet në dispozicion formulari i faturës nga drejtoritë/zyrat vendore të ASHK-së, nëpërmjet portalit unik qeveritar *e-Albania*.

3. Personave juridik iu vendoset në dispozicion formulari nga degët përkatëse të bankave. Gjithashtu, ky formular mund të shkarkohet edhe elektronikisht në faqen zyrtare të DPT-së.

4. Për personin juridik është e detyrueshme që, përveç të dhënave të nënshkruesit, në faturën për arkëtim të plotësohen, gjithashtu, emri i personit juridik (shoqërisë) dhe NIPT/NUIS. Pas verifikimit për plotësimin e të dhënave të plota, banka në zbatim të marrëveshjes dypalëshe me Ministrinë e Financave pranon të kryejë arkëtimin, duke evidentuar llojin e së ardhurës, si dhe kodin e institucionit, sikurse është përcaktuar në “Faturën për arkëtim”, në bazë të kodit të të cilave do të kryhet kontabilizimi në sistemin informatik financiar të qeverisë (SIFQ).

5. Tatimi mbi të ardhurat nga rivlerësimi i pasurive të paluajtshme (5%), që paguhet nga individ, arkëtohet në një llogari të veçantë të hapur nga çdo drejtori vendore e ASHK-së pranë bankave të nivelit të dytë. Drejtoritë vendore të ASHK-së operojnë si agentë tatimorë për arkëtimin në buxhetin e shtetit të këtyre të ardhurave. Brenda datës 10 të muajit pasardhës, vlera e tatimit kalohet në llogarinë e rivlerësimit të pasurive të paluajtshme në buxhetin e shtetit në kodin e të ardhurave 7020900, në drejtoritë tatimore përkatëse.

Brenda së njëjtës datë (të çdo muaji pasardhës), drejtoritë vendore të ASHK-së dërgojnë në drejtoritë tatimore përkatëse evidencën manuale dhe/ose elektronike, me të dhënat e individit që ka kryer rivlerësimin e pasurisë, si dhe shumën e tatimit të llogaritur nga rivlerësimi.

6. Llogaritja dhe arkëtimi i tatimit 5% për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme të personave juridikë bëhet nga drejtoritë rajonale tatimore përkatëse. Ky tatim llogaritet si diferencë ndërmjet vlerës së rivlerësimit dhe vlerës kontabël të pasurisë

të regjistruar në pasqyrat financiare të vitit 2025. Kontabilizimi i tatimit nga rivlerësimi i pasurisë së personave juridikë (5%) do të bëhet në llogarinë ekonomike të të ardhurave 7020400, për llogari të buxhetit të shtetit.

Banka transferon arkëtimet në llogaritë bankare përkatëse në emër të degës së thesarit të çdo rrethi për çdo drejtori rajonale tatimore, sipas kodeve përkatëse të çdo drejtorie.

Drejtoritë rajonale tatimore, çdo muaj, bëjnë rakordimin me degën e thesarit për arkëtimet e kryera, në përputhje me këtë udhëzim.

7. Në raste të derdhjeve gabim të tatimit të rivlerësimit për individët dhe detyrimit për të kthyer tërësisht ose pjesërisht shumën, drejtoritë vendore të ASHK-së hartojnë dokumentacionin justifikues për kthimin e shumës tek individ, pas kërkesës së individit.

7.1. Në rast se individ paraqet kërkesën për kthim shumë, brenda datës 10 të muajit pasardhës, drejtoria vendore e ASHK-së bën drejtpërdrejt kthimin e shumës së arkëtuar gabim. Nëse është tejkaluar ky afat dhe të ardhurat kanë kaluar në buxhetin e shtetit, kërkesën, individ duhet ta paraqesë për kthimin e shumës së mbajtur gabim pranë drejtorisë tatimore përkatëse.

7.2. Në funksion të kthimit të shumës së mbajtur gabim, drejtoria vendore e ASHK-së dërgon dokumentacionin justifikues provues pranë drejtorisë tatimore përkatëse, e cila pas administrimit të dokumentacionit kthen shumën e mbajtur gabim tek individ.

VIII. TARIFA E SHËRBIMIT

1. Tarifa për shërbimin e rivlerësimit për individët, pranë ASHK-së, është si më poshtë:

Nr.	Vlera e tatimit 5% i rivlerësimit që do të derdhet në buxhet	Tarifa e shërbimit për rivlerësimin e pasurisë
1	Deri në 150,000 lekë	3,500 lekë
2	150,001–300,000 lekë	7,000 lekë
3	Mbi 300,001 lekë	10,000 lekë

2. Ky shërbim do të ketë kodin RVP në kërkesën për rivlerësim.

IX. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Pas kryerjes së rivlerësimit për individët, sipas këtij udhëzimi, në rastet e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme të rivlerësuar, në zbatim të ligjit nr. 29, datë 30.3.2023, “Për tatimin



mbi të ardhurat”, të ndryshuar, tatimi llogaritet sipas normave në fuqi mbi fitimin e realizuar, si diferencë e vlerës në momentin e kalimit të së drejtës së pronësisë, me vlerën e rivlerësuar, për të cilën është paguar tatimi.

2. Aplikimet për rivlerësim të pasurive të cilat paraqiten pranë ASHK-së, brenda datës 31 dhjetor 2026, por nuk janë përfunduar, procedohen edhe pas kësaj date, nëse tatimi i rivlerësimit paguhet brenda datës 31 mars 2027.

3. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE

Petrit Malaj

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

I AGJENCISË SHETETËRORE

TË KADASTRËS

Lorena Goxhobelli



SHTOJCA NR.1
KËRKESË
PËR RIVLERËSIMIN E PASURISË SË PALUAJTSHME

1.TË DHËNAT E KËRKESËS

Nr. _____, Datë ____/____/____, Afati i përfundimit ____ (x ditë-nga e nesërmja e konfirmimit të pagesës)

AGJENCIA SHETETËRORE E KADASTRËS-Drejtoria Vendore/Zyra _____

Aplikimi realizuar nga: _____

2. TË DHËNAT E SUBJEKTIT ¹

Emër, Atësi, Mbiemër/Emërtimi tregëtar:

Nr i dokumentit të identifikimit

ID/NUIS:

Adresa:

Lloji _____ dhe numri _____ i dokumentit të identifikimit

Tel:

Adresa e subjektit:

2.1.Përfaqësuesi i autorizuar është i njëjtë me aplikantin?² PO ☐ JO ☐

Emër, Atësi, Mbiemër/Emërtimi tregëtar:

Nr i dokumentit të identifikimit

ID/NUIS:

Adresa:

Lloji _____ dhe numri _____ i dokumentit të identifikimit

Tel:

Adresa e subjektit:

**Numri _____ dhe data ____/____/____ e dokumentit të përfaqësimit*

3. TË DHËNAT E PASURISË

Nr.rendor	Nr.zonës kadastrale	Nr.pasurisë	Kodi Unik (ZK-Volum-)	Bashkia	Adresa
1					
2					
3					
4					
...					

²Kërkesa për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme mund të realizohet vet nga subjekti , ose nga përfaqësuesi i autorizuar, në emër dhe për llogari të subjektit, në përputhje me nenin 72 të Kodit Civil duke plotësuar të dhënat (numri dhe data) e aktit të përfaqësimit dhe duke ja bashkëlidhur atë kërkesës.

**4. DOKUMENTACIONI SHOQËRUES**

<i>Nr. rendor</i>	<i>Lloji i dokumentit</i>	<i>Numri i dokumentit</i>	<i>Data e dokumentit</i>	<i>Numri i fletëve</i>
1				
2				
3				
4				
....				

5. SHËRBIMET, TARIFAT DHE MENYRA E PERLLOGARITJES SE TATIMIT TE RIVLERESIMIT

<i>Nr. rendor</i>	<i>Emërtimi i shërbimit</i>	<i>Kodi i Shërbimit</i>	<i>Njësia/Sasia</i>	<i>Vlera e tarifës (lekë)</i>	<i>Tarifa Totale</i>	<i>Vlera e rivlerësimit sipas çmimeve minimale fiskale/vlera sipas aktit të ekspertimit</i>	<i>Vlera e pasurisë së aktit të regjistruar/të rivlerësuar</i>
1							
2							
3							
4...							
TOTALI							

Nëpërmjet kësaj kërkesë autorizoj institucionin të përpunojë të dhënat e mia personale në përmbajtje të saj, me qëllim zhvillimin e sondazheve të automatizuara për marrjen e opinionit, në lidhje me cilësinë e shërbimit të ofruar.

**Tatimi për rivlerësimin llogaritet si diferencë e vlerës së dalë nga rivlerësimi me çmimet minimale fiskale/ vlerës së dalë nga akti i ekspertimit jo më pak se çmimet minimale fiskale minus vlerën e pasurisë sipas aktit të regjistruar/ të rivlerësuar.*



SHTOJCA NR. 2
DEKLARIMI VULLNETAR PËR RIVLERËSIMIN E PASURIVE TË
PALUAJTSHME TË PERSONAVE JURIDIKË

Drejtuar: Drejtorisë Rajonale të Tatimeve: _____

Deklarim vullnetar për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme

Unë z./znj. _____, përfaqësuesi i personit juridik _____, me NIPT/NUIS _____, me adresë _____, pajisur me autorizim për përfaqësim _____, deklaroj se në bazë të ligjit nr. 85/2025, “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”, deklaroj vullnetin tim për të kryer rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme të regjistruar në pasqyrën financiare (bilanci kontabël) të periudhës _____.

Baza e tatueshme = (diferenca midis vlerës që rezulton nga rivlerësimi, sipas aktit të ekspertit dhe të vlerës kontabël të regjistruar në pasqyrat financiare (në shifra dhe fjalë)

Pagesa = 5% x bazën e tatueshme _____

Emri/mbiemri: _____
(nënshkrimi)

Data: _____



SHTOJCA NR.3



FATURË PËR ARKETIM

Drejtoria Vendore / Zyra: _____

NIPT: _____

Data dhe ora e lëshimit të faturës: _____

Nr.fature: _____

Adresa: _____

Klienti: _____

Nr. i kërkesës për shërbime ____, datë / /

ID/NUIS: _____

	Përshkrimi i shërbimit	Kodi i llogarisë ekonomike	Përfituesi	Banka / IBAN	Vlera (lekë)
1	Shërbime (...)	7112300	DVASHK	IBAN	
2	Shërbime (...)	7112300	DVASHK	IBAN	

	Emërtimi i të ardhurës	Kodi i llogarisë ekonomike	Përfituesi	Banka / IBAN	Vlera (lekë)
3	Tatim për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme (5%)		DVASHK	IBAN	

PAGESA PËR ASHK	Të ardhura për ASHK (1+2)	
	Tatim për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme (5%) (3)	

PAGESA TOTALE PËR APLIKIMIN (1+2+3)

Pagesa mund të kryhet edhe përmes Postës Shqiptare sha.

Kjo faturë është miratuar me Urdhërin nr. 35, datë 11.11.2009 nga Ministria e Financave.



33147169-33147169-33147169

1.Tarifat e shërbimeve kadastrale janë të miratuara me VKM nr.389, datë 13.05.2020, i ndryshuar.

2.Tarifa për rivlerësimin është miratuar me udhëzim të Ministrit të Financave dhe Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK-së “Për përcaktimin e procedurave të zbatimit të ligjit nr.85/2025 “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”, për llogaritjen e bazës së tatueshme, paraqitjen dhe administrimin e kërkesës për rivlerësim, pagesën e tatimit të rivlerësimit, rregullat e procedurave për pasqyrimin e rivlerësimit të pasurisë në regjistrat e pasurive të paluajtshme, pagesën e të ardhurave nga tatimi i rivlerësimit në buxhetin e shtetit, si dhe për përcaktimin e tarifës së kryerjes së shërbimeve të parashikuara nga ky ligj”.

3.Tatimi i rivlerësimit llogaritet në bazë të Udhëzimit të Përmashket MF-ASHK “Për përcaktimin e procedurave të zbatimit të ligjit nr.85/2025 “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”, për llogaritjen e bazës së tatueshme, paraqitjen dhe administrimin e kërkesës për rivlerësim, pagesën e tatimit të rivlerësimit, rregullat e procedurave për pasqyrimin e rivlerësimit të pasurisë në regjistrat e pasurive të paluajtshme, pagesën e të ardhurave nga tatimi i rivlerësimit në buxhetin e shtetit, si dhe për përcaktimin e tarifës së kryerjes së shërbimeve të parashikuara nga ky ligj”.



SHTOJCA NR.4



Drejtoria e
Përgjithshme e
Tatimeve

FATURË PËR ARKËTIM

Nr. _____ më: ____/____/20____

BANKËS _____

Me anë të kësaj fature kërkohet që Banka e Nivelit të Dytë të pranojë nga klientë (persona / persona fizik / persona juridik) arkëtime të të ardhurave, për llogari të institucionit tonë, me emërtime, kode dhe shuma si më poshtë:

Emri i institucionit përfitues: Drejtoria Rajonale Tatimore

NIPT: _____

Kodi i institucionit përfitues: 1010____

Kodi i degës së Thesarit: _____

Emër Mbiemër i klientit/subjektit: _____

NIPT: _____

Nr. i aplikimit: _____

Nr.	Përshkrimi i të ardhurave		Shuma e arkëtimit (Në lekë)
	Emërtimi	Kodi i llogarisë ekonomike	
1	Të ardhura tatimore nga rivlerësimi i pasurisë së personave juridike (5%)	7020400	_____
	TOTALI		_____

INSTITUCIONI: KLIENTI:

(Emër Mbiemër)

Person juridik _____

NIPT/NUIS: _____

Administratori/përfaqësuesi

_____ Emër/mbiemër/nënshkrimi

Adresa: _____

Kontakti: _____



URDHËR

Nr. 154, datë 16.2.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË
SHFAQUR NË MBRETËRINË
E BASHKUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu, të shfaqur në Mbretërinë e Bashkuar, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
England	Barnsley	Barnsley*
England	Bath and North East Somerset	Bath and North East Somerset*
England	Buckinghamshire	Buckinghamshire*
England	Bournemouth, Christchurch and Poole	Bournemouth, Christchurch and Poole*
England	Bracknell Forest	Bracknell Forest*
England	Bradford	Bradford*
England	Calderdale	Calderdale*
England	Cambridgeshire	East Cambridgeshire*
England	Cambridgeshire	South Cambridgeshire*
England	Central Bedfordshire	Central Bedfordshire*
England	Cheshire East	Cheshire East*
England	Cheshire West and Chester	Cheshire West and Chester*
England	Cornwall	Cornwall*
England	Derbyshire	Amber Valley*
England	Derbyshire	Bolsover*
England	Derbyshire	Derbyshire Dales*
England	Derbyshire	High Peak*

England	Derbyshire	North East Derbyshire*
England	Devon	East Devon*
England	Devon	Mid Devon*
England	Devon	Teignbridge*
England	Devon	South Hams*
England	Devon	West Devon*
England	Dorset	Dorset*
England	Gloucestershire	Stroud*
England	East Riding of Yorkshire	East Riding of Yorkshire*
England	East Sussex	Rother*
England	East Sussex	Lewes*
England	East Sussex	Wealden*
England	Essex	Braintree*
England	Essex	Brentwood*
England	Essex	Chelmsford*
England	Essex	Colchester*
England	Essex	Epping Forest*
England	Essex	Maldon*
England	Essex	Harlow*
England	Essex	Tendring*
England	Greater London	Harrow*
England	Herefordshire, County of	Herefordshire, County of*
England	Hertfordshire	Dacorum*
England	Hertfordshire	East Hertfordshire*
England	Hertfordshire	Hertsmere*
England	Hertfordshire	Three Rivers*
England	Medway	Medway*
England	Milton Keynes	Milton Keynes*
England	Shropshire	Shropshire*
England	Kent	Ashford*
England	Kent	Canterbury*
England	Kent	Dover*
England	Kent	Gravesham*
England	Kent	Folkestone and Hythe*
England	Kent	Maidstone*
England	Kent	Sevenoaks*
England	Kent	Swale*
England	Kent	Tonbridge and Malling*
England	Kent	Tunbridge Wells*
England	Kirklees	Kirklees*
England	Isle of Wight	Isle of Wight*
England	Somerset	Somerset Council*
England	Suffolk	East Suffolk*
England	Suffolk	Babergh*
England	Suffolk	Mid Suffolk*
England	Suffolk	Waverley*
England	Suffolk	West Suffolk*
England	Surrey	Guildford*
England	Surrey	Runnymede*
England	Hampshire	Basingstoke and Deane*



England	Hampshire	East Hampshire*
England	Hampshire	Eastleigh*
England	Hampshire	Hart*
England	Hampshire	Test Valley*
England	Hampshire	New Forest*
England	Hampshire	Winchester*
England	Lancashire	Chorley*
England	Lancashire	Hyndburn*
England	Lancashire	Lancaster*
England	Lancashire	Ribble Valley*
England	Leicestershire	Charnwood*
England	Leicestershire	Harborough*
England	Leicestershire	Hinckley and Bosworth*
England	Leicestershire	North West Leicestershire*
England	Lincolnshire	East Lindsey*
England	Lincolnshire	West Lindsey*
England	Lincolnshire	South Kesteven*
England	Staffordshire	East Staffordshire*
England	Staffordshire	Stafford*
England	Staffordshire	Staffordshire Moorlands*
England	Staffordshire	South Staffordshire*
England	Southampton	Southampton*
England	South Gloucestershire	South Gloucestershire*
England	Stockport	Stockport*
England	Norfolk	Breckland*
England	Norfolk	Broadland*
England	Norfolk	Great Yarmouth*
England	Norfolk	King's Lynn and West Norfolk*
England	Norfolk	South Norfolk*
England	Norfolk	North Norfolk*
England	North Yorkshire	North Yorkshire Council*
England	Nottinghamshire	Bassetlaw*
England	Oxfordshire	South Oxfordshire*
England	Oxfordshire	Vale of White Horse*
England	Tameside	Tameside*
England	Trafford	Trafford*
England	Thurrock	Thurrock*
England	York	York*
England	West Berkshire	West Berkshire*
England	Wiltshire	Wiltshire*
England	Wokingham	Wokingham*
England	Westmorland and Furness Council	Westmorland and Furness Council*
England	West Sussex	Arun*
England	West Sussex	Chichester*
England	West Sussex	Horsham*
Isle of Man	Glenfaba	Patrick*

Isle of Man	Middle	Braddan*
Isle of Man	Rushen	Arbory*
Jersey	Saint Berlade	Saint Berlade*
Jersey	Saint John	Saint John*
Jersey	Saint Martin	Saint Martin*
Jersey	Saint Peter	Saint Peter*
Jersey	Saint Saviour	Saint Saviour*
United Kingdom Exclusive Economic Zone	Brightlingsea*	
United Kingdom Exclusive Economic Zone	Middleton*	
Wales	Denbighshire	Denbighshire*
Wales	Monmouthshire	Monmouthshire*
Wales	Powys	Powys*
Wales	Wrexham	Wrexham*
Northern Ireland	North Down and Ards	Ards*
Northern Ireland	Ards and North Down	North Down*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve



Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) Janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjithë stereotipave, të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitropa për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitropave ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ç) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitropat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinare shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve në pikat 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 98, datë 2.2.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në Mbretërinë e Bashkuar”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i



Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 155, datë 16.2.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E POLONISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
1.	Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Susz*
2.	Warmińsko-Mazurskie	Kętrzyn	Reszel*
3.	Wielkopolskie	Ostrzeszów	Mikstat*
4.	Wielkopolskie	Turek	Kawęczyn*
5.	Wielkopolskie	Turek	Przykona*
6.	Warmińsko-Mazurskie	Ostróda	Grunwald*
7.	Wielkopolskie	Konin	Rzgów*
8.	Warmińsko-Mazurskie	Węgorzewo	Pozezdrze*

9.	Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Ilawa (rural)*
10.	Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Zalewo*
11.	Małopolskie	Tarnów	Wojnicz*
12.	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Środa Wielkopolska*
13.	Lubuskie	Międzyrzecz	Skwierzyna*
14.	Warmińsko-Mazurskie	Bartoszyce	Bartoszyce (rural)*
15.	Lubuskie	Sulęcín	Krzeszyc*
16.	Mazowieckie	Białobrzegi	Stara Błotnica*
17.	Kujawsko-Pomorskie	Inowrocław	Gniewkowo*
18.	Opolskie	Namysłów	Pokój*
19.	Kujawsko-Pomorskie	Chełmno	Lisewo*
20.	Lubuskie	Świebodzin	Lubrza*
21.	Lubuskie	Gorzów	Deszczno*
22.	Wielkopolskie	Poznań	Mosina*
23.	Warmińsko-Mazurskie	Nidzica	Janowiec Kościelny*
24.	Warmińsko-Mazurskie	Węgorzewo	Węgorzewo*
25.	Mazowieckie	Żuromin	Lutocin*
26.	Pomorskie	Kartuzy	Somonino*
27.	Łódzkie	Poddębice	Pęczniew*
28.	Pomorskie	Słupsk	Kobylnica*
29.	Wielkopolskie	Kalisz	Szczytniki*
30.	Wielkopolskie	Kalisz	Koźminek*
31.	Lubuskie	Żagań	Malomice*
32.	Lubuskie	Gorzów	Bogdaniec*
33.	Lubelskie	Parczew	Siemień*
34.	Lubelskie	Radzyń Podlaski	Wołyń*
35.	Lubelskie	Biała Podlaska	Międzyrzec Podlaski (rural)*
36.	Podlaskie	Hajnówka	Narew*
37.	Mazowieckie	Mława	Szydłowo*
38.	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Zaniemiśl*
39.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Ostrów Wielkopolski (rural)*
40.	Lubuskie	Gorzów	Lubiszyn*
41.	Wielkopolskie	Wolsztyn	Przemęt*
42.	Wielkopolskie	Turek	Budzew*
43.	Wielkopolskie	Kalisz	Opatówek*
44.	Pomorskie	Kartuzy	Sulęcyno*
45.	Wielkopolskie	Śrem	Brodnica*
46.	Śląskie	Pszczyna	Pszczyna*
47.	Wielkopolskie	Turek	Władysławów*
48.	Kujawsko-Pomorskie	Żnin	Rogowo*
49.	Kujawsko-Pomorskie	Bydgoszcz	Koronowo*
50.	Zachodniopomorskie	Stargard	Dobrzany*
51.	Warmińsko-Mazurskie	Giżycko	Giżycko (rural)*
52.	Dolnośląskie	Legnica	Prochowice*
53.	Wielkopolskie	Ostrzeszów	Grabów Prosną*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informon të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të



patrajtuar termikisht, për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht, që vijnë nga vendet e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

7. Urdhri nr. 153, datë 13.2.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

VENDIM
Nr. 23, datë 30.1.2026

**MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
E BORDIT TË ERE-s NR. 190, DATË
12.8.2025, “MBI LICENCIMIN E
SHOQËRISË ‘ENERGOVIA.ALBANIA’
SHPK NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të rregullores “Për organizimin,

funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.1.2026, mbasi shqyrtoi relacionin e për gatitur nga Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Mbikëqyrjes së të Licencuarve, me nr. 113/2 prot., datë 27.1.2026, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 190, datë 12.8.2025, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Energovia.Albania’ sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

**1. Të dhëna mbi shoqërinë
“Energovia.Albania” sh.p.k.**

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 190, datë 12.8.2025, ka licencuar shoqërinë “Energovia.Albania” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5- vjeçar (pesëvjeçar).

- Referuar pikës 2 të vendimit nr. 190/2025 dhe sa konstatuar në këtë vendim, shoqëria “Energovia.Albania” sh.p.k., brenda datës 1.2.2026, duhet të depozitojë në ERE kontratat e rinovuara për shërbimet e jashtme, ose çdo dokument tjetër në lidhje me disponimin e stafit teknik. (shërbime ligjore dhe të kontabilitetit).

- Gjithashtu, në pikën 3 të këtij vendimi është përcaktuar se ky vendim është objekt rishikimi në lidhje me plotësimin ose mosplotësimin e pikës 2 të tij.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- ERE, në kuadër të ndjekjes së kushteve të vendimit nr. 190/2025, me shkresën nr. 3033 prot., datë 12.12.2025, i ka kërkuar shoqërisë “Energovia.Albania” sh.p.k. depozitim të kontratave të rinovuara për shërbimet e jashtme, me afat vlefshmërie që të mbulojë gjithë periudhën e licencës, deri më 12.8.2030.

- Shoqëria, me *email*-in e protokolluar në ERE me nr. 3033/1 prot., datë 22.12.2025, ka depozituar:

- “Kontratën për ofrimin e shërbimeve të kontabilitetit”, të lidhur më datë 1.12.2025, ndërmjet shoqërisë “Energovia.Albania” sh.p.k. dhe audituesit ligjor/ekspertit kontabël z. A.H., me afat vlefshmërie deri më 31.8.2030;

- “Kontratën për ofrimin e shërbimeve ligjore”, të lidhur më datë 1.12.2025, ndërmjet shoqërisë “Lwx Business” sh.p.k. dhe shoqërisë “Energovia.Albania” sh.p.k., me afat vlefshmërie deri më 31.8.2030.



- ERE, me *email*-in e datës 6.1.2026, të protokolluar me nr. 23, datë 6.1.2026, në zbatim të nenit 8, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, i ka kërkuar shoqërisë që dokumentacioni i depozituar të paraqitet në formën e kërkuar nga kjo rregullore.

- Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 113/1 prot., datë 22.1.2026, ka depozituar kontratat origjinale për shërbimet e sipërcituara.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Referuar dokumentacionit të depozituar për shërbimet e jashtme, konkretisht kontratës për ofrimin e shërbimeve të kontabilitetit dhe kontratës për ofrimin e shërbimeve ligjore, si dhe kërkesës së rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” (pika 1.2, germa “c”), vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtin e vendosur në pikën 2 të vendimit nr. 190/2025, pasi afati i vlefshmërisë së kontratave (deri më 31.8.2030) mbulon periudhën e licencës (deri më 12.8.2030).

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në mbështetje të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të ndryshohet ose shfuqizohet nga organi që e ka nxjerrë atë, vlerësohet se pika 2 e vendimit nr. 190/2025 duhet të shfuqizohet.

- Me shfuqizimin e pikës 2, nuk gjen më zbatim edhe pika 3 e vendimit nr. 190/2025, ndaj lind nevoja për shfuqizimin e saj.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e ERE-s nr. 190, datë 12.8.2025, si vijon:

- a) Pika 2 shfuqizohet;
- b) Pika 3 shfuqizohet.

2. Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Mbikëqyrjes së të Licencuarve, të njoftojë shoqërinë “Energovia.Albania” sh.p.k., lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data

e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM Nr. 24, datë 30.1.2026

MBI VLERËSIMIN E RAPORTIT VJETOR TË ZYRTARIT TË PËRPUTHSHMËRISË SË SHOQËRISË “ALBGAZ” SHA, PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT TË PËRPUTHSHMËRISË PËR VITIN 2024

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 16 dhe 47, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; vendimit të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 171, datë 16.8.2021, “Për miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror, ‘Albgaz’ sh.a.”, i ndryshuar me vendimin nr. 345, datë 21.12.2022; vendimit të Bordit të ERE-s nr. 355, datë 28.12.2022, i ndryshuar, “Mbi miratimin paraprak të Zyrtarit të Përputhshmërisë së ‘Albgaz’ sh.a.”, i ndryshuar me vendimin nr. 133, datë 7.4.2023; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.1.2026, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Pajtuëshmërisë dhe Vlerësimit të Impaktit Rregullator dhe Drejtoria e Gazit Natyror, me nr. 321 prot., datë 23.1.2026, “Mbi vlerësimin e Raportit Vjetor të Përputhshmërisë së operatorit të gazit natyror ‘Albgaz’ sh.a. për vitin 2024”,

konstatoi se:

- Në zbatim të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar dhe të Programit të Përputhshmërisë të miratuar nga Bordi i ERE-s,



përputhshmëria me Programin monitorohet në mënyrë të pavarur nga Zyrtari i Përputhshmërisë, i cili përgatit dhe depoziton pranë ERE raportin vjetor mbi masat e marra për zbatimin e Programit, brenda afateve të përcaktuara.

ERE, në ushtrim të kompetencave të saj mbikëqyrëse dhe vlerësuese, shqyrton raportimin e paraqitur nga Zyrtari i Përputhshmërisë, me qëllim garantimin e pavarësisë funksionale/menaxheriale, transparencës dhe trajtimit jodiskriminues në sektorin e gazit natyror.

1. Dorëzimi dhe shqyrtimi i raportit për vitin 2024

- Zyrtari i Përputhshmërisë i “Albgaz” sh.a., me shkresën nr. 1141/2 prot., datë 25.4.2025, ka depozituar pranë ERE Raportin Vjetor të Përputhshmërisë së “Albgaz” sh.a. për vitin 2024.

- Pas analizës së kryer, ERE, me shkresën nr. 1141/5 prot., datë 1.8.2025, i ka kërkuar Zyrtarit plotësim me informacion dhe dokumentacion shtesë mbi përmbajtjen e raportit, lidhur me: i. respektimin e afateve ligjore për dorëzimin e raportit; ii. pasaktësitë në përmbajtjen e raportit; iii. mungesat e dokumentacionit që dëshmojnë përfshirjen e Zyrtarit në proceset e ndarjes së pronësisë dhe pavarësisë funksionale; iv. funksionalitetin dhe transparencën e faqes zyrtare të shoqërisë; v. masat për garantimin e konfidencialitetit të informacionit; vi. përfshirjen e zyrtarit në planifikimin afatgjatë të rrjetit; vii. projektet e gazifikimit; si dhe viii. raportimin mbi statusin e rekomandimeve të mëparshme.

- Në vijim, Zyrtari, me shkresën nr. 1141/6 prot., datë 16.8.2025, ka paraqitur informacion plotësues, i cili nuk ka shteruar plotësisht kërkesat e ERE-s, për këtë arsye në përputhje me kuadrin ligjor dhe aktet e brendshme procedurale, ERE ka zhvilluar seancë dëgjimore me Zyrtarin dhe është dakordësuar ridërgimi i raportit përfundimtar me plotësimet përkatëse.

- Në përfundim, Zyrtari, me shkresën nr. 1141/14 prot., datë 20.10.2025, ka dorëzuar në ERE Raportin Vjetor përfundimtar të Përputhshmërisë së “Albgaz” sh.a. për vitin 2024.

2. Vlerësimi i përmbajtjes së raportit

- Raporti vjetor përbëhet nga: i. informacion i përgjithshëm mbi zbatimin e Programit; ii. rekomandimet e Zyrtarit; iii. konkluzione.

- ERE, në vlerësimin e tij, ka marrë në konsideratë informacionin që lidhet me

përmbushjen e kërkesave të Programit të Përputhshmërisë, duke u fokusuar në elementet dhe kriteret që lidhen drejtpërdrejt me këto detyrime. Çdo informacion tjetër i trajtuar nga Zyrtari, që nuk është pjesë e kërkesave të Programit, nuk është përfshirë dhe nuk përbën qëllim të vlerësimit.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 179, datë 8.11.2017, “Mbi certifikimin e shoqërisë ‘Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror ‘Albgaz’ sh.a.’”, ka përcaktuar, ndër të tjera, kërkesa për: pavarësinë e audituesit financiar, si dhe bashkëpunimin ndërinstitucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor (neni 11 dhe neni 46, pika 10, të ligjit nr. 102/2015) dhe transferimin e kompetencave të Ministria e Ekonomisë dhe Financave.

- Në lidhje me ndarjen ligjore të shoqërisë “Albgaz” sh.a., në raportin e Zyrtarit nuk është trajtuar në mënyrë eksplicite struktura e pronësisë dhe raporti me autoritetin që ushtron të drejtat e aksionarit, megjithëse kjo çështje rezulton e përcaktuar në aktet e krijimit dhe organizimit të shoqërisë “Albgaz” sh.a., sipas VKM-së nr. 848/2016 dhe akteve përkatëse të organizimit shtetëror. Për rrjedhojë, kjo nuk përbën mungesë të ndarjes ligjore, por mungesë referimi të plotë në raportim.

- Nga vlerësimi i kryer rezultojnë çështje që kërkojnë përmirësim dhe plotësim në raportimet pasardhëse, veçanërisht lidhur me: i. raportimin e dokumentuar mbi pavarësinë e audituesit financiar dhe përmbushjen e kushteve të certifikimit; ii. pasqyrimin e ndryshimeve në strukturën organizative dhe provat miratuese përkatëse; iii. identifikimin dhe dokumentimin e ndarjes ligjore/funksionale dhe pavarësisë menaxheriale; iv. monitorimin e detyrimeve për publikim/transparencë (përfshirë aksesueshmërinë e dokumenteve dhe vendimeve përkatëse); v. masat konkrete për konfidencialitetin e informacionit; vi. metodologjinë e monitorimit dhe evidencat e pjesëmarrjes/njoftimeve në mbledhje; vii. respektimin e afateve të raportimit sipas Programit; viii. pasqyrimin e statusit të rekomandimeve dhe detyrave specifike të lëna nga ERE.

3. Nevoja për përmirësim dhe rekomandime për periudhën pasardhëse

- Bazuar në vlerësimin e mësipërm, ERE çmon të nevojshme që Zyrtari i Përputhshmërisë dhe “Albgaz” sh.a. të marrin masa për adresimin e



rekomandimeve/detyrimeve të evidentuara, sipas Aneksve 1 dhe 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e pjesshëm të Raportit Vjetor të Zyrtarit të Përputhshmërisë së shoqërisë “Albgaz” sh.a., për vitin 2024, në kuptim të vlerësimeve/konstatimeve të ERE-s të pasqyruara në këtë vendim.

2. Zyrtari i Përputhshmërisë dhe shoqëria “Albgaz” sh.a. të marrin masat për zbatimin e rekomandimeve sipas aneksit 1 dhe aneksit 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Drejtoria e Pajtueshmërisë dhe Impaktit Rregullator, të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturë dhe Energjisë, të njoftojë shoqërinë “Albgaz” sh.a., Zyrtarin e Përputhshmërisë, Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

ANEKSI 1

REKOMANDIME PËR ZYRTARIN E PËRPUTHSHMËRISË NË VIJIM TË VLERËSIMIT TË RAPORTIT VJETOR TË PËRPUTHSHMËRISË PËR VITIN 2024

1. Statusi ligjor dhe struktura e “Albgaz” sh.a.:

a) Zyrtari Përputhshmërisë të monitorojë zbatimin e kërkesës për pavarësinë e audituesit financiar, në përputhje me pikën 5.1 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, “Mbi certifikimin e shoqërisë ‘Operatori i Kombinuar i

Gazit Natyror ‘Albgaz’ sh.a.”, dhe të pasqyrojë në raportimet në vijim nivelin e përmbushjes së kësaj kërkesë, duke **monitoruar dhe raportuar** mbi respektimin nga operatori që të mos emërojë auditues financiarë që auditojnë ose kryejnë detyra për ndërmarrje që ushtrojnë veprimtari të prodhimit ose furnizimit të gazit natyror.

b) Zyrtari i Përputhshmërisë të vijojë të raportojë në raportimet pasardhëse për çdo ndryshim të ndodhur mbi strukturën organizative të operatorit “Albgaz” sh.a. Raportimi të bëhet duke përfshirë dhe deklarimin mbi aktet e miratimit të kësaj strukture të re në përputhje me detyrimet e përcaktuara në pikën 16.4 të Programit të Përputhshmërisë. Në vijim, Zyrtari duhet të pasqyrojë çdo ndryshim në nivelet drejtuese apo ekzekutive gjatë periudhës së monitorimit, me qëllim rritjen e transparencës dhe mundësimin e një vlerësimi të plotë mbi strukturën organizative të shoqërisë.

2. Ndarja dhe pavarësia e “Albgaz” sh.a

Ndarja funksionale dhe Pavarësia drejtuese funksionale dhe vendimmarrëse: Në raportin pasardhës, Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të pasqyrojë në mënyrë të qartë, të mbështetur në evidenca dhe informacion të verifikueshëm pranë operatorit, veprimet që lidhen me sigurimin e pavarësisë funksionale dhe menaxheriale të shoqërisë, duke shmangur raportimin vetëm në formë deklarative. Raportimi duhet të demonstrojë përputhshmërinë me detyrimet e përcaktuara në **Programin e Përputhshmërisë**, nëpërmjet përshkrimit të masave të ndërmarra, mekanizmave të kontrollit dhe mënyrës së zbatimit të tyre gjatë periudhës së monitorimit.

3. Përjashtimi i sjelljes diskriminuese

Aksesi në sistemin e transmetimit: Në kuadër të monitorimit të përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në pikën 27 të Programit të Përputhshmërisë, Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të kryejë verifikime periodike mbi publikimin, përditësimin dhe aksesueshmërinë në faqen zyrtare të “Albgaz” sh.a. të tarifave të transmetimit dhe vendimmarrjeve përkatëse të Enti Rregullator i Energjisë. Këto verifikime duhet të pasqyrohen në raportimet pranë ERE në mënyrë të detajuar, duke evidentuar elementet e verifikuara, kohën e kryerjes së verifikimeve, konstatimet e rezultuara (përfshirë raste të mungesës së publikimit, vonesave apo pasaktësive), si dhe masat e marra ose të



rekomanduara për korrigjimin e tyre. Raportimi nuk duhet të kufizohet në deklarime të përgjithshme të përputhshmërisë, por duhet të mbështetet në evidenca dhe konstatime konkrete që rrjedhin nga veprimtaria monitoruese e ushtruar nga Zyrtari.

4. Politika e informacionit të “Albgaz” sh.a.:

a) Sigurimi i informacionit: Zyrtari të monitorojë dhe të raportojë që publikimi dhe akses i këtij informacioni është në përputhje me përcaktimet e pikës 37 të Programit.

b) Zyrtari i Përputhshmërisë duhet, në kuadër të funksionit të tij monitorues, të verifikojë dhe të raportojë në raportimet pasardhëse mbi ekzistencën dhe zbatimin nga Operatori të masave që lidhen me ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit, përfshirë nëse në kontratat e punonjësve parashikohen dispozita për ruajtjen e informacionit konfidencial dhe pasoja financiare në rast të mosrespektimit të këtij detyrimi, në përputhje me pikën 50 të Programit të Përputhshmërisë.

c) Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të monitorojë dhe të raportojë mbi përmbushjen e detyrimeve të transparencës nga Operatori, duke verifikuar nëse informacioni i detyrueshëm sipas pikës 53 të Programit është i publikuar, i përditësuar dhe i aksesueshëm në faqen zyrtare.

5. Zbatimi i Programit

a) Karakteri detyrues i Programit: Raporti i Zyrtarit duhet të pasqyrojë në mënyrë të përmbledhur rekomandimet e dhëna gjatë periudhës së raportimit, si dhe çdo zhvillim që lidhet me licencimin dhe detyrimet rregullatore, me qëllim sigurimin e një pamjeje të qartë mbi përputhshmërinë dhe veprimtarinë e Operatorit.

b) Monitorimi i zbatimit të Programit: Zyrtari duhet të ushtrorë në mënyrë aktive të gjitha të drejtat dhe detyrimet e monitorimit që i ngarkohen nga legjislacioni në fuqi dhe Programi i Pajtushmërisë të cilat përfshijnë, ndër të tjera: pjesëmarrjen në mbledhjet e organeve drejtuese dhe strukturave përkatëse të Operatorit, kur trajtohen çështje që lidhen me Programin e Përputhshmërisë; verifikimin periodik të zbatimit të masave dhe detyrimeve të Programit në strukturat e Operatorit; mbledhjen dhe shqyrtimin e dokumentacionit përkatës, lidhur me zbatimin e Programit; ndjekjen e publikimeve dhe transparencës së informacionit të detyrueshëm; dokumentimin e veprimtarive monitoruese dhe pasqyrimin e tyre në raportimet periodike dhe vjetore pranë ERE-s.

c) Metoda e monitorimit të zbatimit të Programit të Përputhshmërisë: Zyrtari duhet të përforcojë mekanizmat e monitorimit të zbatimit të Programit, duke mos u kufizuar vetëm në shkëmbimin e korrespondencës shkresore, por duke ushtruar një monitorim aktiv, të vazhdueshëm dhe të dokumentuar.

d) Raportimi dhe zbatimi Programit: Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të sigurojë respektimin e afateve të raportimit të përcaktuara në pikën 73 të Programit të Përputhshmërisë. Në rast se konstaton pamundësi objektive për respektimin e këtyre afateve, ai duhet të njoftojë paraprakisht ERE-n, duke paraqitur një arsyetim të dokumentuar dhe të argumentuar mbi shkaqet e vonësës, si dhe masat e marra për të shmangur përsëritjen e rasteve të tilla në raportimet pasardhëse.

e) Zbatimi i Përputhshmërisë duhet të sigurojë që në raportet vjetore të përfshihet një pasqyrë e qartë mbi statusin e rekomandimeve të dhëna nga ERE në raportimin e mëparshëm, duke evidentuar nivelin e përmbushjes së tyre, masat e ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve të papërfunduara dhe ecurinë e tyre gjatë periudhës së monitorimit.

ANEKSI 2

REKOMANDIME PËR SHOQËRINË “ALBGAS” SHA NË VIJIM TË VLERËSIMIT TË RAPORTIT VJETOR TË PËRPUTHSHMËRISË PËR VITIN 2024

1. Statusi ligjor dhe struktura organizative

a) Shoqëria “Albgaz” sh.a. duhet të informojë dhe të vërë në dispozicion të Zyrtarit të Përputhshmërisë dhe ERE-s dokumentacionin që dëshmon respektimin e kërkesës për pavarësinë e audituesit financiar, në përputhje me kushtet e vendosura në vendimin e certifikimit, përfshirë deklarin se audituesi financiar nuk ushtron veprimtari auditimi, apo shërbime për ndërmarrje që kryejnë veprimtari prodhimi ose furnizimi me gaz natyror.

b) Shoqëria duhet të dokumentojë çdo ndryshim në strukturën organizative dhe në nivelet drejtuese apo ekzekutive, si dhe të sigurojë akses të Zyrtarit të Përputhshmërisë në njohjen me aktet miratuese.

2. Ndarja dhe pavarësia e shoqërisë

Shoqëria “Albgaz” sh.a. duhet të vijojë të sigurojë ruajtjen e ndarjes ligjore dhe organizative të veprimtarisë së transmetimit të gazit natyror si



subjekt juridik i veçantë, në përputhje me aktet themeluese dhe Programin e Përputhshmërisë, si dhe të dokumentojë në raportimet pasardhëse çdo element që lidhet me strukturën e pronësisë dhe ushtrimin e të drejtave të aksionarit nga autoriteti publik përkatës.

3. Përjashtimi i sjelljes diskriminuese

Shoqëria duhet të sigurojë publikimin në faqen zyrtare të internetit të vendimeve të ERE-s, tarifave dhe akteve rregullatore përkatëse, si dhe të garantojë që dokumentet që janë të detyrueshme për t'u publikuar të jenë të aksesueshme dhe të përditësuara.

4. Politika e informacionit

a) Shoqëria duhet të zbatojë detyrimet për publikimin dhe aksesin në informacion në përputhje me kërkesat e Programit të Përputhshmërisë, duke garantuar që informacioni i detyrueshëm për përdoruesit e sistemit dhe palët e interesuara të jetë i publikuar, i përditësuar dhe lehtësisht i aksesueshëm në faqen zyrtare, përfshirë listën e shërbimeve, kushtet dhe procedurat për përfitimin e tyre (pika 53).

b) Shoqëria “Albgaz” sh.a. duhet të sigurojë që në kontratat e punonjësve të përfshihen dispozita mbi ruajtjen e informacionit konfidencial, si dhe pasoja financiare në rast të mosrespektimit të këtij detyrimi, në përputhje me pikën 50 të Programit të Përputhshmërisë. Shoqëria duhet të sigurojë publikimin e informacionit të detyrueshëm për përdoruesit e sistemit dhe palët e interesuara, përfshirë listën e shërbimeve, kushtet dhe procedurat për përfitimin e tyre.

5. Zbatimi i Programit të Përputhshmërisë

a) Shoqëria duhet të sigurojë zbatimin e karakterit detyrues të Programit të Përputhshmërisë në të gjitha strukturat dhe nivelet organizative.

b) Shoqëria duhet të sigurojë njoftimin paraprak dhe në kohë të Zyrtarit të Përputhshmërisë për çdo mbledhje të organeve drejtuese, ku trajtohen çështje që lidhen me zbatimin e Programit të Përputhshmërisë, duke i vënë në dispozicion rendin e ditës, materialet shoqëruese dhe vendimmarrjet përkatëse, si dhe duke dokumentuar këto njoftime dhe pjesëmarrjen e Zyrtarit për qëllime monitorimi.

c) Shoqëria duhet të bashkëpunojë me Zyrtarin e Përputhshmërisë, duke i garantuar akses në dokumentacion, struktura dhe informacion të nevojshëm për monitorimin e zbatimit të Programit.

VENDIM

Nr. 26, datë 4.2.2026

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “NOVA SOLAR SYSTEM” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e”, dhe 13 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordin i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.2.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 7/6 prot., datë 30.1.2026, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Nova Solar System’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”, konstatoi se:

- Shoqëria “Nova Solar System” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 7 prot., datë 6.1.2026, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Bordin i ERE-s, me vendimin nr. 6, datë 15.1.2026, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 16.1.2026 dhe 17.1.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve, apo objeksioneve nga të tretët (data 26.1.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Gjithashtu, njoftimi për fillimin e procedurës u botua në rrjetet sociale dhe në faqen e internetit të ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 7/3 prot., datë 22.1.2026, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës për licencimin e saj, si dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin e munguar për këtë aplikim.

- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 7/4 prot., datë 22.1.2026 dhe nr. 7/5 prot., datë 26.1.2026, shoqëria ka depozituar dokumentacionin e munguar të aplikimit.



- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi, rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e nevojshëm për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Nova Solar System” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “Nova Solar System” sh.p.k., OST sh.a., OSSH sh.a. dhe ALPEX sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM Nr. 27, datë 4.2.2026

MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË “TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT” SHPK, PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 14, pika 3, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe

nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.2.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 66/4 prot., datë 2.2.2026, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “Tirana International Development” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Tirana International Development” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 146, datë 24.6.2021, deri më 24.6.2026

- Shoqëria ka paraqitur kërkesën për rinovimin e kësaj licence, me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 2983/1 prot., datë 24.12.2025, brenda afatit të përcaktuar nga Rregullorja.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 1, datë 8.1.2026, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 9.1.2026 dhe 10.1.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 19.1.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Gjithashtu, njoftimi për fillimin e procedurës u botua në rrjetet sociale dhe në faqen e internetit të ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 66/1 prot., datë 15.1.2026, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës për licencimin e saj, si dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 66/2 prot., datë 22.1.2026, shoqëria ka depozituar informacion/dokumentacion shtesë, nga shqyrtimi i të cilit rezulton se duhet të plotësojë dokumentacionin e mbështetjes financiare dhe të depozitojë planin e biznesit të nënshkruar/vulosur nga hartuesi, dokumentacion i cili i është kërkuar shoqërisë dhe me *email*-in e datës 28.1.2026.

Zgjatja e vendimmarrjes së Bordit:

- Në nenin 14, pika 3, parashikohet, se: *Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.*



- Për t'i dhënë mundësi shoqërisë “Tirana International Development” sh.p.k. që të depozitojë dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar për këtë aplikim, në rrethanat e një aplikimi për rinovim, vlerësohet që të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Shoqëria duhet të depozitojë këtë dokumentacion brenda 10 (dhjetë) ditëve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes për aplikimin e shoqërisë “Tirana International Development” sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 146, datë 24.6.2021.

2. Shoqëria të depozitojë në ERE dokumentacionin e munguar brenda 10 (dhjetë) ditëve.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Tirana International Development” sh.p.k., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 29, datë 4.2.2026

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “NOVA SOLAR SYSTEM” SHPK, PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET MARRËVESHJES SIGURUESE) TË ASETVE FIKSE TË SAJ, SI MJET PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ “RAIFFEISEN BANK” SHA

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa “a”, dhe 44 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 2, germa “a”, 3, 4,

germat “a” dhe “b”, 5, germa “j”, 6, 7 dhe 8 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016; nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe pikave 1.3 dhe pikës 1.6, të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.2.2026, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 62/2 prot., datë 29.1.2026, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Nova Solar System’ sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për barrësimin e aseteve fikse të saj, në favor të ‘Raiffeisen Bank’ sh.a.”,

konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënie e autorizimit për shoqërinë “Nova Solar System” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Shoqëria “Nova Solar System” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 242, datë 3.8.2023 për centralin fotovoltaiik me kapacitet 50 mw, në zonën kadastrale nr. 3358, fshati Sheq Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Shoqëria me shkresën nr. 62/1 prot., datë 19.1.2026 ka paraqitur kërkesë dhe dokumentacion për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosjen e aseteve të të licencuarit, si mjet (barrë siguruese) për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj Raiffeisen Bank sh.a.

- Kërkesa e mësipërme, ka ardhur në rrethanat kur më herët nga shoqëria është përcjellë shkresa nr. 3109 prot., datë 22.12.2025, me anë të së cilës është kërkuar vetëm marrja e autorizimit për barrësimin e kuotave, por sa konstatuar nga ana jonë në dokumentacionin e përcjellë, rezulton se kredimarrësi detyrohet dhe garanton të paraqesë në favor të bankës *aprovimet përkatëse në lidhje me kuotat dhe transferimin e aseteve të parkut fotovoltaiik*. Ndaj, ERE, me shkresën nr. 62 prot., datë 8.1.2026, i ka sjellë në vëmendje të shoqërisë se në referencë të nenit 4, germa “b”, dhe nenit 2 të rregullores me nr. 119/2016, jep miratimin për transferimin e aseteve fikse të të licencuarit të përdorura për kryerjen e



veprimtarisë së licencuar, me vlerë më të madhe se 150,000,000 lekë, si e tillë, ju kërkua depozitimi i aplikimit përkatës dhe dokumentacionit referuar nenit 7 të rregullores 119/2016 në fuqi.

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe i dokumentacionit të paraqitur

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe të neneve 2, germa “a”, 3, 5, germa “j”, dhe 6 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licensuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, rezulton se ERE miraton kërkesat e të licensuarave për transferimin e aseteve fikse (të paluajtshme) që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në mbështetje të përcaktimeve të nenit 7 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licensuarit”, rezulton se nevojitet të plotësohet dhe dokumentacioni në vijim:

Neni 7, pika 1:

- **Germa “c”:** Shoqëria duhet të bëjë me dije në lidhje me gjendjen financiare aktuale të saj dhe efektin që parashikon pas miratimit të transferimit të aseteve.

- **Germa “d”:** Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin e kërkuar në lidhje me kandidatin e propozuar për transferimin e aseteve (Raiffeisen Bank sh.a.).

- **Germa “i”:** Shoqëria duhet të paraqesë deklaratën, që të shprehë gatishmërinë e bankës për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licencuar, në rast të transferimit të aseteve.

- **Germa “j”:** Shoqëria duhet të bëjë me dije nëse ka pasur transferime të kryera më herët nga ana saj.

- **Pika 6:** Shoqëria nuk ka bërë me dije nëse ka pjesë të dokumentacionit të përcjellë që kërkon të mos jetë e hapur për publikun, ndaj do t'i kërkohej kjo në vijim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Nova Solar System” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet marrëveshjes siguruese) të aseteve fikse të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a., që rrjedhin nga

kontratat e kredive nr. 7303 rep., nr. 3488 kol., datë 6.10.2023 dhe nr. 10975 rep., nr. 4604 kol., datë 19.12.2025, si dhe nga marrëveshja siguruese nr. 10979 rep., nr. 4608 kol., datë 19.12.2025.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “Nova Solar System” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 30, datë 4.2.2026

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHËNË SHOQËRISË “BREÇANI - R.O.S.P” SHPK, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 9, DATË 21.1.2022

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 5, germa “ç”; 6 dhe 7 të rregullores “Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe pikës 6.1, germa “ç”, të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.2.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 453 prot., datë 2.2.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit



dhe Autorizimeve, Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financës, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore për pagesat e rregullimit të vitit 2025 të pashlyera ndaj ERE-s”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Breçani - R.O.S.P” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 497, seria P22, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 9, datë 21.1.2022.

- Me vendimin e Bordit nr. 112, datë 23.5.2025, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2025 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

- Ky vendim është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 105, datë 17.6.2025. Përveç marrjes dijeni nga Fletorja Zyrtare, të licencuarit i është dërguar fatura e fiskalizuar, së bashku me detyrimin respektiv.

- Rezulton se i licencuari “Breçani - R.O.S.P” sh.p.k. nuk e ka kundërshtuar vendimin e Bordit të ERE-s nr. 112/2025, dhe nuk ka përcjellë në ERE dokumentacion mbi mosshlyerjen e detyrimit, ndaj konstatohet se ky i licencuar ka kryer shkeljen si vijon: *Mosshlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2025.*

- Ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në nenin 107 parashikon, se, për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit, si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2 % të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në germën “ç”, të nenit 42, parashikon, se: “ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji”.

- Sa i përket masës administrative “gjobë”, referuar parashikimeve të sipërcituara ligjore, përlllogaritja e masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore dhe në bazë të të dhënave të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, rezulton se kjo masë nuk mund të aplikohet për të gjitha subjektet debitore ndaj pagesës së rregullimit të vitit 2025, pasi ka subjekte që nuk e kanë ushtruar veprimtarinë e licencuar për vitin paraardhës e për këtë arsye në zbatim të rregullores për miratimin e pagesave rregullatore, i është vendosur shuma fikse.

- Duke qenë se ligji ka parashikuar të drejtën e ERE-s të marrë masa administrative të përshkallëzuara për llojin e shkeljes (mosshlyerje e pagesave të rregullimit të vitit 2025), që nga vendosja e gjobës e deri në heqjen e licencës, vlerësohet që në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, të licencuarit të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke qenë se shkelja është e njëjtë për të gjithë dhe të vijohet me masën administrative që mund të aplikohet për të gjithë të licencuarit, duke filluar me procedurat përkatëse për heqjen e licencës, sipas parashikimeve të nenit 5, germa “ç”, dhe nenit 6 të rregullores “Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017.

- Neni 6 i rregullores “Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikon, se: “Në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijeni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE. Në asnjë rast subjekti i licencuar debtor, nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës”.

- Në nenin 7 të rregullores është parashikuar e drejta e të licencuarit për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 497, seria P22, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Breçani - R.O.S.P” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 9, datë 21.1.2022.

2. I licencuari ka të drejtë për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Breçani - R.O.S.P” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund



ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 31, datë 4.2.2026

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
HEQJEN E LICENCËS PËR
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE DHËNË
SHOQËRISË “ENERGY MARKET
ALBANIA” SHPK, ME VENDIMIN E
BORDIT TË ERE-s NR. 138,
DATË 14.4.2023**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 5, germa “ç”; 6 dhe 7 të rregullores “Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe pikës 5.1, germa “ç”, të “Kushteve të licencës për tregtimin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.2.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 453 prot., datë 2.2.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financës, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore për pagesat e rregullimit të vitit 2025 të pashlyera ndaj ERE-s”, konstatoi se:

- Shoqëria “Energy Market Albania” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 555, seria T23, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 138, datë 14.4.2023.

- Me vendimin e Bordit nr. 112, datë 23.5.2025, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2025 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

- Ky vendim është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 105, datë 17.6.2025. Përveç marrjes dijeni nga Fletorja Zyrtare, të licencuarit i është dërguar fatura e fiskalizuar, së bashku me detyrimin respektiv.

- Rezulton se i licencuari “Energy Market Albania” sh.p.k. nuk e ka kundërshtuar vendimin e Bordit të ERE-s nr. 112/2025, dhe nuk ka përcjellë në ERE dokumentacion mbi moshlyerjen e detyrimit, ndaj konstatohet se ky i licencuar ka kryer shkeljen si vijon: “Mosshlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2025”.

- Ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në nenin 107 parashikon, se: për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit, si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2 % të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në germën “ç” të nenit 42 parashikon, se: ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.

- Sa i përket masës administrative “gjobë”, referuar parashikimeve të sipërcituara ligjore, përlllogaritja e masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore dhe në bazë të të dhënave të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, rezulton se kjo masë nuk mund të aplikohet për të gjitha subjektet debitore ndaj pagesës së rregullimit të vitit 2025, pasi ka subjekte që nuk e kanë ushtruar veprimtarinë e licencuar për vitin paraardhës e për këtë arsye në zbatim të rregullores për miratimin e pagesave rregullatore, i është vendosur shuma fikse.

- Duke qenë se ligji ka parashikuar të drejtën e ERE-s të marrë masa administrative të përshkallëzuara për llojin e shkeljes (mosshlyerje e pagesave të rregullimit të vitit 2025), që nga vendosja e gjobës e deri në heqjen e licencës, vlerësohet që në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, të licencuarit të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke qenë se shkelja është e njëjtë për të gjithë dhe të vijohet me masën administrative që mund të aplikohet për të gjithë të licencuarit, duke filluar me procedurat



përkatëse për heqjen e licencës, sipas parashikimeve të neneve 5, germa “ç” dhe 6 të rregullores “Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017.

- Neni 6 i rregullores “Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikon se në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijeni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE-s. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor, nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE-s, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës.

- Në nenin 7 të rregullores është parashikuar e drejta e të licencuari për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 555, seria T23, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Energy Market Albania” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 138, datë 14.4.2023.

2. I licencuari ka të drejtë për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Energy Market Albania” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 32, datë 4.2.2026

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHËNË SHOQËRISË “GERTI” SHPK, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 99, DATË 16.4.2021

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 5, germa “ç”; 6 dhe 7 të rregullores “Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe pikës 6.1, germa “ç”, të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.2.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 453 prot., datë 2.2.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financës, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitorë për pagesat e rregullimit të vitit 2025 të pashlyera ndaj ERE-s”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Gerti” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 489, seria P21, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 16.4.2021.

- Me vendimin e Bordit nr. 112, datë 23.5.2025, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2025 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

- Ky vendim është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 105, datë 17.6.2025. Përveç marrjes dijeni nga Fletorja Zyrtare, të licencuarit i është dërguar fatura e fiskalizuar, së bashku me detyrimin respektiv.

- Rezulton se i licencuari “Gerti” sh.p.k. nuk e ka kundërshtuar vendimin e Bordit të ERE-s nr. 112/2025, dhe nuk ka përcjellë në ERE dokumentacion mbi moshlyerjen e detyrimit, ndaj



konstatohet se ky i licencuar ka kryer shkeljen si vijon: Mosshlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2025.

- Ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në nenin 107 parashikon, se: “për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit, si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2 % të xhiros ditorë për çdo ditë vonesë në pagesën e saj”, dhe në germën “ç” të nenit 42 parashikon, se: “ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.”

- Sa i përket masës administrative “gjobë”, referuar parashikimeve të sipërcituara ligjore, përllogaritja e masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore dhe në bazë të të dhënave të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, rezulton se kjo masë nuk mund të aplikohet për të gjitha subjektet debitorë ndaj pagesës së rregullimit të vitit 2025, pasi ka subjekte që nuk e kanë ushtruar veprimtarinë e licencuar për vitin paraardhës e për këtë arsye në zbatim të rregullores për miratimin e pagesave rregullatore, i është vendosur shuma fikse.

- Duke qenë se ligji ka parashikuar të drejtën e ERE-s të marrë masa administrative të përshkallëzuara për llojin e shkeljes (mosshlyerje e pagesave të rregullimit të vitit 2025) që nga vendosja e gjobës e deri në heqjen e licencës, vlerësohet që në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, të licencuarit të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke qenë se shkelja është e njëjtë për të gjithë dhe të vijohet me masën administrative që mund të aplikohet për të gjithë të licencuarit, duke filluar me procedurat përkatëse për heqjen e licencës, sipas parashikimeve të nenit 5, germa “ç” dhe nenit 6 të rregullores “Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017.

- Neni 6 i rregullores “Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikon, se: “në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dëni, të

shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE-s. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor, nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE-s, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës”.

- Në nenin 7 të rregullores është parashikuar e drejta e të licencuarit për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 489, seria P21, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Gerti” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 16.4.2021.

2. I licencuari ka të drejtë për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Gerti” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dëni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 33, datë 4.2.2026

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
HEQJEN E LICENCËS PËR
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE DHËNË
SHOQËRISË “GERTI” SHPK, ME
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s
NR. 362, DATË 7.12.2023**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 5, germa “ç”; 6 dhe 7, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe pikës 6.1, germa “ç”, të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.2.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 453 prot., datë 2.2.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financës, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitoare për pagesat e rregullimit të vitit 2025 të pashlyera ndaj ERE-s”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Gerti” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 570, seria P23, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 362, datë 7.12.2023.

- Me vendimin e Bordit nr. 112, datë 23.5.2025, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2025 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

- Ky vendim është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 105, datë 17.6.2025. Përveç marrjes dijeni nga Fletorja Zyrtare, të licencuarit i është dërguar fatura e fiskalizuar, së bashku me detyrimin respektiv.

- Rezulton se i licencuari “Gerti” sh.p.k. nuk e ka kundërshtuar vendimin e Bordit të ERE-s nr. 112/2025, dhe nuk ka përcjellë në ERE dokumentacion mbi moshlyerjen e detyrimit, ndaj

konstatohet se ky i licencuar ka kryer shkeljen si vijon: “Mosshlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2025.”.

- Ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në nenin 107 parashikon se: “Për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit, si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2 % të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në germën “ç”, të nenit 42 parashikon se, ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.”.

- Sa i përket masës administrative “gjobë”, referuar parashikimeve të sipërcituara ligjore, përllogaritja e masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore dhe në bazë të të dhënave të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, rezulton se kjo masë nuk mund të aplikohet për të gjitha subjektet debitoare ndaj pagesës së rregullimit të vitit 2025, pasi ka subjekte që nuk e kanë ushtruar veprimtarinë e licencuar për vitin paraardhës e për këtë arsye, në zbatim të rregullores për miratimin e pagesave rregullatore, i është vendosur shuma fikse.

- Duke qenë se ligji ka parashikuar të drejtën e ERE-s të marrë masa administrative të përshkallëzuara për llojin e shkeljes (mosshlyerje e pagesave të rregullimit të vitit 2025) që nga vendosja e gjobës e deri në heqjen e licencës, vlerësohet që në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, të licencuarit të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke qenë se shkelja është e njëjtë për të gjithë dhe të vijohet me masën administrative që mund të aplikohet për të gjithë të licencuarit, duke filluar me procedurat përkatëse për heqjen e licencës, sipas parashikimeve të nenit 5, germa “ç” dhe nenit 6 të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017.

- Neni 6, i “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikon se: “Në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijeni, të



shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE-s. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor, nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE-s, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës.”.

- Në nenin 7, të rregullores është parashikuar e drejta e të licencuarit për t’u përgjigjur me shkrim, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 570, seria P23, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Gerti” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 362, datë 7.12.2023.

2. I licencuari ka të drejtë për t’u përgjigjur me shkrim, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Gerti” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 34, datë 4.2.2026

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHËNË SHOQËRISË “GERTI” SHPK, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 54, DATË 22.2.2021

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 5, germa “ç”; 6 dhe 7, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe të pikës 5.1, germa “ç”, të “Kushteve të licencës për tregtimin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.2.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 453 prot., datë 2.2.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financës, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitorë për pagesat e rregullimit të vitit 2025 të pashlyera ndaj ERE-s”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Gerti” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 484, seria T21, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 54, datë 22.2.2021.

- Me vendimin e Bordit nr. 112, datë 23.5.2025, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2025 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

- Ky vendim është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 105, datë 17.6.2025. Përveç marrjes dijeni nga Fletorja Zyrtare, të licencuarit i është dërguar fatura e fiskalizuar, së bashku me detyrimin respektiv.

- Rezulton se i licencuari “Gerti” sh.p.k. nuk e ka kundërshtuar vendimin e Bordit të ERE-s nr. 112/2025, dhe nuk ka përcjellë në ERE dokumentacion mbi moshlyerjen e detyrimit, ndaj



konstatohet se ky i licencuar ka kryer shkeljen si vijon: “Mosshlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2025.”.

- Ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në nenin 107 parashikon se: “Për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit, si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2 % të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në germën “ç”, të nenit 42 parashikon se, ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.”.

- Sa i përket masës administrative “gjobë”, referuar parashikimeve të sipërcituara ligjore, përllogaritja e masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore dhe në bazë të të dhënave të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, rezulton se kjo masë nuk mund të aplikohet për të gjitha subjektet debitorë ndaj pagesës së rregullimit të vitit 2025, pasi ka subjekte që nuk e kanë ushtruar veprimtarinë e licencuar për vitin paraardhës e për këtë arsye në zbatim të rregullores për miratimin e pagesave rregullatore, i është vendosur shuma fikse.

- Duke qenë se ligji ka parashikuar të drejtën e ERE-s të marrë masa administrative të përshkallëzuara për llojin e shkeljes (mosshlyerje e pagesave të rregullimit të vitit 2025) që nga vendosja e gjobës e deri në heqjen e licencës, vlerësohet që në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, të licencuarit të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke qenë se shkelja është e njëjtë për të gjithë dhe të vijohet me masën administrative që mund të aplikohet për të gjithë të licencuarit, duke filluar me procedurat përkatëse për heqjen e licencës, sipas parashikimeve të neneve 5, germa “ç” dhe 6, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.04.2017.

- Neni 6 i “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikon se: “Në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dëni, të

shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE-s. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor, nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE-s, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës.”.

- Në nenin 7 të rregullores është parashikuar e drejta e të licencuarit për t’u përgjigjur me shkrim, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 484, seria T21, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Gerti” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 54, datë 22.2.2021.

2. I licencuari ka të drejtë për t’u përgjigjur me shkrim, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Gerti” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dëni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 35, datë 4.2.2026

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
HEQJEN E LICENCËS PËR
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE DHËNË
SHOQËRISË “HEC TRESKA” SHPK, ME
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s
NR. 80, DATË 24.7.2013**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 5, germa “ç”; 6 dhe 7, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe të pikës 6.1, germa “ç”, të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.2.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 453 prot., datë 2.2.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financës, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitoare për pagesat e rregullimit të vitit 2025 të pashlyera ndaj ERE-s”,

konstatoi se:

- Shoqëria “HEC Treska” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 202, seria PV13K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 80, datë 24.7.2013.

- Me vendimin e Bordit nr. 112, datë 23.5.2025, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2025 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

- Ky vendim është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 105, datë 17.6.2025. Përveç marrjes dijeni nga Fletorja Zyrtare, të licencuarit i dërguar fatura e fiskalizuar, së bashku me detyrimin respektiv.

- Rezulton se i licencuari “HEC Treska” sh.p.k. nuk e ka kundërshtuar vendimin e Bordit të ERE-s nr. 112/2025, dhe nuk ka përcjellë në ERE dokumentacion mbi moshlyerjen e detyrimit, ndaj

konstatohet se ky i licencuar ka kryer shkeljen si vijon: “Mosshlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2025.”.

- Ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në nenin 107 parashikon se: “Për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit, si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2 % të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në germën “ç”, të nenit 42 parashikon se, ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.”.

- Sa i përket masës administrative “gjobë”, referuar parashikimeve të sipërcituara ligjore, përlllogaritja e masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore dhe në bazë të të dhënave të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, rezulton se kjo masë nuk mund të aplikohet për të gjitha subjektet debitoare ndaj pagesës së rregullimit të vitit 2025, pasi ka subjekte që nuk e kanë ushtruar veprimtarinë e licencuar për vitin paraardhës e për këtë arsye në zbatim të rregullores për miratimin e pagesave rregullatore, i është vendosur shuma fikse.

- Duke qenë se ligji ka parashikuar të drejtën e ERE-s të marrë masa administrative të përshkallëzuara për llojin e shkeljes (mosshlyerje e pagesave të rregullimit të vitit 2025) që nga vendosja e gjobës e deri në heqjen e licencës, vlerësohet që në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, të licencuarit të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke qenë se shkelja është e njëjtë për të gjithë dhe të vijohet me masën administrative që mund të aplikohet për të gjithë të licencuarit, duke filluar me procedurat përkatëse për heqjen e licencës, sipas parashikimeve të nenit 5, germa “ç” dhe nenit 6, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017.

- Neni 6 i “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikon se në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijeni, të



shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE-s. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor, nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE-s, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës.

- Në nenin 7 të rregullores është parashikuar e drejta e të licencuarit për t'u përgjigjur me shkrim, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 202, seria PV13K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “HEC Treska” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 80, datë 24.7.2013.

2. I licencuari ka të drejtë për t'u përgjigjur me shkrim, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “HEC Treska” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 36, datë 4.2.2026

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHËNË SHOQËRISË “HYDRO POWER PLANT OF KORCA” SHPK, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 38, DATË 5.4.2012

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 5, germa “ç”; 6 dhe 7, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe të pikës 6.1, germa “ç”, të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016; Bordin i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.2.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 453 prot., datë 2.2.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financës, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitorë për pagesat e rregullimit të vitit 2025 të pashlyera ndaj ERE-s”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Hydro Power Plant of Korca” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 154, seria PV12K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 38, datë 5.4.2012.

- Me vendimin e Bordit nr. 112, datë 23.5.2025, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2025 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

- Ky vendim është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 105, datë 17.6.2025. Përveç marrjes dijeni nga Fletorja Zyrtare, të licencuarit i është dërguar fatura e fiskalizuar, së bashku me detyrimin respektiv.

- Rezulton se i licencuari “Hydro Power Plant of Korca” sh.p.k. nuk e ka kundërshtuar vendimin e Bordit të ERE-s nr. 112/2025, dhe nuk ka përcjellë



në ERE dokumentacion mbi detyrimet, ndaj konstatohet se ky i licencuar ka kryer shkeljen si vijon: “Mosshlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2025.”.

- Ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në nenin 107 parashikon se: “Për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit, si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2 % të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në germën “ç”, të nenit 42 parashikon se: ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.”.

- Sa i përket masës administrative “gjobë”, referuar parashikimeve të sipërcituara ligjore, përllogaritja e masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore dhe në bazë të të dhënave të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, rezulton se kjo masë nuk mund të aplikohet për të gjitha subjektet debitorë ndaj pagesës së rregullimit të vitit 2025, pasi ka subjekte që nuk e kanë ushtruar veprimtarinë e licencuar për vitin paraardhës, e për këtë arsye, në zbatim të rregullores për miratimin e pagesave rregullatore, i është vendosur shuma fikse.

- Duke qenë se ligji ka parashikuar të drejtën e ERE-s të marrë masa administrative të përshkallëzuara për llojin e shkeljes (mosshlyerje e pagesave të rregullimit të vitit 2025) që nga vendosja e gjobës e deri në heqjen e licencës, vlerësohet që në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, të licencuarit të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke qenë se shkelja është e njëjtë për të gjithë dhe të vijohet me masën administrative që mund të aplikohet për të gjithë të licencuarit, duke filluar me procedurat përkatëse për heqjen e licencës, sipas parashikimeve të nenit 5, germa “ç” dhe nenit 6, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017.

- Neni 6, i “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikon se në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për

heqjen e licencës duhet që me marrjen dijëni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE-s. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor, nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE-s, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës.

- Në nenin 7 të rregullores është parashikuar e drejta e të licencuarit për t’u përgjigjur me shkrim, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 154, seria PV12K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Hydro Power Plant of Korca” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 38, datë 5.4.2012.

2. I licencuari ka të drejtë për t’u përgjigjur me shkrim, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Hydro Power Plant of Korca” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijëni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti



VENDIM
Nr. 37, datë 4.2.2026

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
HEQJEN E LICENCËS PËR
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE DHËNË
SHOQËRISË “KORKIS-2009” SHPK, ME
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s
NR. 21, DATË 4.3.2011**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 5, germa “ç”; 6 dhe 7, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe pikës 6.1, germa “ç”, të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.2.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 453 prot., datë 2.2.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financës, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitoare për pagesat e rregullimit të vitit 2025 të pashlyera ndaj ERE-s”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Korkis-2009” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 119, seria PV11K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 21, datë 4.3.2011.

- Me vendimin e Bordit nr. 112, datë 23.5.2025, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2025 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

- Ky vendim është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 105, datë 17.6.2025. Përveç marrjes dijeni nga Fletorja Zyrtare, të licencuarit i është dërguar fatura e fiskalizuar, së bashku me detyrimin respektiv.

- Rezulton se i licencuari “Korkis-2009” sh.p.k. nuk e ka kundërshtuar vendimin e Bordit të ERE-s nr. 112/2025, dhe nuk ka përcjellë në ERE dokumentacion mbi mosshlyerjen e detyrimit, ndaj

konstatohet se ky i licencuar ka kryer shkeljen si vijon: “Mosshlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2025.”.

- Ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në nenin 107 parashikon se: “Për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit, si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2 % të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në germën “ç”, të nenit 42 parashikon se: ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.”.

- Sa i përket masës administrative “gjobë”, referuar parashikimeve të sipërcituara ligjore, përlllogaritja e masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore dhe në bazë të të dhënave të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, rezulton se kjo masë nuk mund të aplikohet për të gjitha subjektet debitoare ndaj pagesës së rregullimit të vitit 2025, pasi ka subjekte që nuk e kanë ushtruar veprimtarinë e licencuar për vitin paraardhës e për këtë arsye, në zbatim të rregullores për miratimin e pagesave rregullatore, i është vendosur shuma fikse.

- Duke qenë se ligji ka parashikuar të drejtën e ERE-s të marrë masa administrative të përshkallëzuara për llojin e shkeljes (mosshlyerje e pagesave të rregullimit të vitit 2025) që nga vendosja e gjobës e deri në heqjen e licencës, vlerësohet që në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, të licencuarit të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke qenë se shkelja është e njëjtë për të gjithë dhe të vijohet me masën administrative që mund të aplikohet për të gjithë të licencuarit, duke filluar me procedurat përkatëse për heqjen e licencës, sipas parashikimeve të nenit 5, germa “ç” dhe nenit 6, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017.

- Neni 6 i “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikon se: “Në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijeni, të



shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE-s. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor, nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE-s, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës.”.

- Në nenin 7 të rregullores është parashikuar e drejta e të licencuarit për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 119, seria PV11K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Korkis-2009” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 21, datë 4.3.2011.

2. I licencuari ka të drejtë për t’u përgjigjur me shkrim, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Korkis-2009” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 38, datë 4.2.2026

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHËNË SHOQËRISË “MOUNTAIN’S GREEN ENERGY” SHPK, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 283, DATË 18.12.2024

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 5, germa “ç”; 6 dhe 7, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe të pikës 6.1, germa “ç”, të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.2.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 453 prot., datë 2.2.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financës, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitorë për pagesat e rregullimit të vitit 2025 të pashlyera ndaj ERE-s”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Mountain’s Green Energy” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 602, seria P24, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 283, datë 18.12.2024.

- Me vendimin e Bordit nr. 112, datë 23.5.2025, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2025 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

- Ky vendim është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 105, datë 17.6.2025. Përveç marrjes dijeni nga Fletorja Zyrtare, të licencuarit i është dërguar fatura e fiskalizuar, së bashku me detyrimin respektiv.

- Rezulton se i licencuari “Mountain’s Green Energy” sh.p.k. nuk e ka kundërshtuar vendimin e



Bordit të ERE-s nr. 112/2025, dhe nuk ka përcjellë në ERE dokumentacion mbi moshlyerjen e detyrimit, ndaj konstatohet se ky i licencuar ka kryer shkeljen si vijon: “Mosshlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2025.”

- Ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në nenin 107 parashikon se: “Për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit, si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2 % të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në germën “ç”, të nenit 42 parashikon se: ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.”

- Sa i përket masës administrative “gjobë”, referuar parashikimeve të sipërcituara ligjore, përllogaritja e masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore dhe në bazë të të dhënave të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, rezulton se kjo masë nuk mund të aplikohet për të gjitha subjektet debitore ndaj pagesës së rregullimit të vitit 2025, pasi ka subjekte që nuk e kanë ushtruar veprimtarinë e licencuar për vitin paraardhës, e për këtë arsye, në zbatim të rregullores për miratimin e pagesave rregullatore, i është vendosur shuma fikse.

- Duke qenë se ligji ka parashikuar të drejtën e ERE-s të marrë masa administrative të përkallëzuara për llojin e shkeljes (mosshlyerje e pagesave të rregullimit të vitit 2025) që nga vendosja e gjobës e deri në heqjen e licencës, vlerësohet që në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, të licencuarit të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke qenë se shkelja është e njëjtë për të gjithë dhe të vijohet me masën administrative që mund të aplikohet për të gjithë të licencuarit, duke filluar me procedurat përkatëse për heqjen e licencës, sipas parashikimeve të nenit 5, germa “ç” dhe nenit 6, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017.

- Neni 6, i “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikon se në çdo

rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijeni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE-s. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor, nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE-s, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës.

- Në nenin 7 të rregullores është parashikuar e drejta e të licencuarit për t’u përgjigjur me shkrim, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 602, seria P24, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Mountain’s Green Energy” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 283, datë 18.12.2024.

2. I licencuari ka të drejtë për t’u përgjigjur me shkrim, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Mountain’s Green Energy” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM

Nr. 39, datë 4.2.2026

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
HEQJEN E LICENCËS PËR
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE DHËNË
SHOQËRISË “PESHKU-PICAR 1” SHPK,
ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s
NR. 24, DATË 2.3.2012**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 5, germa “ç”; 6 dhe 7, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe pikës 6.1, germa “ç”, të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.2.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 453 prot., datë 2.2.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financës, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitoare për pagesat e rregullimit të vitit 2025 të pashlyera ndaj ERE-s”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Peshku-Picar 1” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 156, seria PV12K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 24, datë 2.3.2012.

- Me vendimin e bordit nr. 112, datë 23.5.2025, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2025 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

- Ky vendim është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 105, datë 17.6.2025. Përveç marrjes dijeni nga Fletorja Zyrtare, të licencuarit i është dërguar fatura e fiskalizuar, së bashku me detyrimin respektiv.

- Rezulton se i licencuari “Peshku-Picar 1” sh.p.k. nuk e ka kundërshtuar vendimin e Bordit të ERE-s nr. 112/2025, dhe nuk ka përcjellë në ERE as

shpjegime dhe as dokumentacion mbi moshlyerjen e detyrimit, ndaj konstatohet se ky i licencuar ka kryer shkeljen, si vijon: “Mosshlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2025.”.

- Ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në nenin 107 parashikon se: “Për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit, si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2 % të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në germën “ç”, të nenit 42 parashikon se ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.”.

- Sa i përket masës administrative “gjobë”, referuar parashikimeve të sipërcituara ligjore, përllogaritja e masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore dhe në bazë të të dhënave të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, rezulton se kjo masë nuk mund të aplikohet për të gjitha subjektet debitoare ndaj pagesës së rregullimit të vitit 2025, pasi ka subjekte që nuk e kanë ushtruar veprimtarinë e licencuar për vitin paraardhës e për këtë arsye, në zbatim të rregullores për miratimin e pagesave rregullatore, i është vendosur shumua fikse.

- Duke qenë se ligji ka parashikuar të drejtën e ERE-s të marrë masa administrative të përshkallëzuara për llojin e shkeljes (mosshlyerje e pagesave të rregullimit të vitit 2025) që nga vendosja e gjobës e deri në heqjen e licencës, vlerësohet që në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, të licencuarit të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke qenë se shkelja është e njëjtë për të gjithë dhe të vijohet me masën administrative që mund të aplikohet për të gjithë të licencuarit, duke filluar me procedurat përkatëse për heqjen e licencës, sipas parashikimeve të nenit 5, germa “ç” dhe nenit 6, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017.

- Neni 6, i “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikon se në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për



heqjen e licencës duhet që me marrjen dijeni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE-s. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor, nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE-s, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës.

- Në nenin 7 të rregullores është parashikuar e drejta e të licencuarit për t'u përgjigjur me shkrim, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 156, seria PV12K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Peshku-Picar 1” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 24, datë 2.3.2012.

2. I licencuari ka të drejtë për t'u përgjigjur me shkrim, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Peshku-Picar 1” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 40, datë 4.2.2026

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHËNË SHOQËRISË “TIRANA ENERGJI” SHPK, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 175, DATË 4.11.2020

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 5, germa “ç”; 6 dhe 7, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe të pikës 6.1, germa “ç”, të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.2.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 453 prot., datë 2.2.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financës, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitorë për pagesat e rregullimit të vitit 2025 të pashlyera ndaj ERE-s”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Tirana Energji” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 473, seria P20, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 175, datë 4.11.2020.

- Me vendimin e Bordit nr. 112, datë 23.5.2025, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2025 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

- Ky vendim është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 105, datë 17.6.2025. Përveç marrjes dijeni nga Fletorja Zyrtare, të licencuarit i është dërguar fatura e fiskalizuar, së bashku me detyrimin respektiv.

- Rezulton se i licencuari “Tirana Energji” sh.p.k. nuk e ka kundërshtuar vendimin e Bordit të ERE-s nr. 112/2025, dhe nuk ka përcjellë në ERE



dokumentacion mbi moshlyerjen e detyrimit, ndaj konstatohet se ky i licencuar ka kryer shkeljen si vijon: “Mosshlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2025.”.

- Ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në nenin 107 parashikon se: “Për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit, si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2 % të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në germën “ç”, të nenit 42 parashikon se, ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.”.

- Sa i përket masës administrative “gjobë”, referuar parashikimeve të sipërcituara ligjore, përllogaritja e masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore dhe në bazë të të dhënave të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, rezulton se kjo masë nuk mund të aplikohet për të gjitha subjektet debitorë ndaj pagesës së rregullimit të vitit 2025, pasi ka subjekte që nuk e kanë ushtruar veprimtarinë e licencuar për vitin paraardhës e për këtë arsye në zbatim të rregullores për miratimin e pagesave rregullatore, i është vendosur shuma fikse.

- Duke qenë se ligji ka parashikuar të drejtën e ERE-s të marrë masa administrative të përshkallëzuara për llojin e shkeljes (mosshlyerje e pagesave të rregullimit të vitit 2025) që nga vendosja e gjobës e deri në heqjen e licencës, vlerësohet që në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, të licencuarit të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke qenë se shkelja është e njëjtë për të gjithë dhe të vijohet me masën administrative që mund të aplikohet për të gjithë të licencuarit, duke filluar me procedurat përkatëse për heqjen e licencës, sipas parashikimeve të nenit 5, germa “ç” dhe nenit 6, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017.

- Neni 6, i “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikon se: “Në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për

heqjen e licencës duhet që me marrjen dijëni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE-s. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor, nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE-s, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës.”.

- Në nenin 7 të rregullores është parashikuar e drejta e të licencuarit për t’u përgjigjur me shkrim, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 473, seria P20, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Tirana Energji” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 175, datë 4.11.2020.

2. I licencuari ka të drejtë për t’u përgjigjur me shkrim, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Tirana Energji” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijëni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrith Ahmeti

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 208 lekë

